



**STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**TEZA: “INVESTIMET E HUAJA DIREKTE DHE NDIKIMI I TYRE NË EKSPORTIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONIË DHE VENDET NË TRANZICION”**

**MENTOR:**

**Prof. Dr Besnik Fetai**

**KANDIDATI:**

**Emrije Murtezani - Qamili**

**Tetovë 2020**

## Mirënjohje

Më lejoni që të shpreh mirënjohjen time të lartë ndaj të gjithë profesorëve të mi të cilët më kanë udhëzuar gjithmonë drejtë, në rrugëtimin tim drejt formimit tim profesional në fushën e ekonomisë dhe financave. Po ashtu, më lejoni që në veçanti, të shpreh mirënjohjen time edhe për mentorin tim, Prof. Dr. Besnik Fetaj, i cili gjatë gjithë kohës më ka udhëzuar dhe këshilluar që ky punim shkencor, të jetë më i mirë dhe sa më profesional.

Falemnderimet e mia më të sinqerta i drejtohen edhe anëtarëve të komisionit, Akademik Abdylmenaf Bexheti dhe Doc.Dr.Nasir Sulejmani, për bashkëpunimin dhe durimin që treguan përgjatë periudhës së realizimit të këtij hulumtimi.

Meritat më të mëdha për arritjet e mia, padyshim që i merr familja ime, e cila më ka përkrahur që nga fillimi dhe pa asnjë kursim. Andaj, edhe ky punim i imi, u dedikohet atyre. Shpresoj që ky nuk do të jetë sukcesi i fundit i imi, pasi që në vitet në vazhdim, do të punoj edhe më shumë dhe të kontribuoj në shoqëri me punime të ndryshme shkencore dhe të ndihmoj sado pak në zgjidhjen e problemeve të shumta ekonomike që ne i hasim në vendin tonë.

## Abstrakti

Padyshim që investimet e huaja direkte kanë rolin kyç në zhvillimin ekonomik të një vendi. Ata janë promotorët që e rrisin produktivitetin, mekanizmat me anë të së cilave mundësohet përdorimi i resurseve të ndryshme natyrore për krijimin e asortimentit të gjërë të produkteve me anë të së cilave shumë njerëz do t'i plotësonin nevojat e tyre të përgjithshme, krijohen vende të reja të punës dhe stimulohet konsumi dhe shitja më e madhe edhe në vendet e ndryshme.

Për vendin I cili i pret këto investime, shpenzimet fillestare janë shumë të ulëta (pothuajse zero), për arsye se ato nuk do t'i harxhojnë resurset financiare për të hapur fabrikë apo ndonjë subjekt tjetër ekonomik. Në një farë mënyre, i vetmi shpenzim që do të ishte, është harxhimi i “kohës”, për të krijuar një terren të volitshëm për investitorët e huaj në sferën legjislative, për t'iu mundësuar atyre që më lehtë të investojnë në vend dhe të hapin subjekte të ndryshme ekonomike, me ç'rast do të stimulonin zhvillimin ekonomik.

Për këtë arsye, investimet e huaja direkte janë “dhurata” më e dëshirueshme nga vendet e ndryshme. Andaj, nëpërmjet këtij punimi, do të mundohem që të përshkruaj dhe të analizoj efektet që kanë këto “dhurata” në vendet e tranzicionit, por me theks të veçantë në Republikën e Maqedonisë.

Metoda që do të përdor, do të jetë Panel Data. Analizat do të bazohen duke marrë të dhena për vendet në tranzicion nga periudha kohore prej 2000 – 2018.

Parashikimet tona në lidhje më efektin e investimeve të huaja direkte janë që investimet e huaja do të kenë efekte positive në rritjen ekonomike të çdo vendi, dhe me këtë presim që edhe hipotezat tona që I kemi paraqitur në këtë punim të vërtetohen me rezultate konkrete dhe relevante.

*Investime te huaja direkte, GDP, eksport, rritje ekonomike, bilanc tregtar...*

## Abstract

Indeed, foreign direct investment plays a key role in the country's economic development. They are productivity-enhancing promoters, mechanisms by which it is possible to use different natural resources to create a wide range of products by which many people would meet their general needs, create jobs new jobs and stimulating consumption and sales even in different countries.

For the country that expects these investments, initial costs are very low (almost zero) because they will not spend the financial resources to open a factory or any other economic entity. In a way, the only expense that would be, is spending "time" to create a favorable ground for foreign investors in the legislative sphere, to enable them to invest more easily in the country and different economic subjects, which could stimulate economic development.

For this reason, foreign direct investment is the most desirable "gift" from different countries. Therefore, through this paper, I will try to describe and analyze the effects of these "gifts" in the transition countries, but with particular emphasis on the Republic of Macedonia.

The method I will use will be Panel Data. Analyses will be based on data on transition countries from 2000 to 2018.

Our predictions regarding the effect of foreign direct investments are that foreign investments will have positive effects on the economic growth of each country, and with this we expect that our hypotheses that we have presented in this paper will be verified with concrete and relevant results.

## Абстракт

Всушност, странските директни инвестиции играат клучна улога во економскиот развој на земјата. Тие се промотори за подобрување на продуктивноста, механизми со кои е можно да се користат различни природни ресурси за да се создаде широк спектар на производи со кои многу луѓе ќе ги задоволат нивните општи потреби, ќе креираат нови работни места нови работни места и стимулирање на потрошувачката и продажбата, дури и во различни земји.

За земјата која очекува овие инвестиции, првичните трошоци се многу ниски (речиси нула), бидејќи тие нема да ги трошат финансиските средства за отворање фабрика или друг економски субјект. На некој начин, единствениот трошок што ќе биде, е да се троши "време" за да се создаде повољна основа за странските инвеститори во законодавната сфера, за да можат полесно да инвестираат во земјата и различни економски субјекти, кои би го стимулирале економскиот развој.

Поради оваа причина, странските директни инвестиции се најпосакуваните "подарок" од различни земји. Затоа, преку овој труд ќе се обидам да ги опишам и анализирам ефектите на овие "подароци" во земјите во транзиција, но со посебен акцент на Република Македонија.

Методот што ќе го користам ќе биде панел податоци. Анализите ќе се базираат на податоци за земјите во транзиција од 2000 до 2018 година.

Нашите предвидувања во врска со влијанието на странските директни инвестиции се дека странските инвестиции ќе имаат позитивни ефекти врз економскиот раст на секоја земја и со тоа очекуваме дека нашите хипотези што ги презентиравме во овој труд ќе бидат потврдени со конкретни и релевантни резултати .

## Permbajtja

- 1) Parathënie .....
- 2) Hyrje .....
- 3) Rishikimi i literaturës .....
- 4) Aspekti Teorik .....
- 5) Investimet e huaja Direkte .....
- a. Faktet e stilizuara mbi investimet e huaja direkte .....
- i. Politikat e Maqedonisë në lidhje me investimet e huaja direkte .....
- ii. Planet, realizimet, të arriturat dhe dështimet e politikës investive në Maqedoni .....
- b. Evidenca empirike e investimet e huaja direkte në vendet në tranzicion .....
- 6) Analiza empirike .....
- a. Modeli ekonometrik dhe metodat e vlerësimit .....
- b. Të dhënat e punimit .....
- c. Rezultatet .....
- 7) Konkluzionet dhe rekomandimet .....

## I.1 HYRJE

Prologun e këtij punimi shkencor do të doja që t'ia filloja me paraqitjen e arsyeve për të cilat kam vendosur që si temë magjistrature e zgjedha pikërisht këtë temë e cila vazhdon të jetë aktuale në jetën tonë ekonomike por edhe atë politike, pa marrë parasysh se në cilin vend jetojmë, qoftë ai vend Evropian apo Ballkanik.

Vazhdimisht, nëpër mjetet e informimit, ne hasim terme të ndryshme siç janë: inflacioni, papunësia, investimet kapitale, investimet monetare, eksport – import, bilanc tregtar etj. Këto terme tashme janë të njohura për shumicën e popullsisë që jetojnë në një vend, pasi që në aktivitetet e tyre të përditshme, ato i praktikojnë dhe i shohin të gjitha këto dukuri të lartpërmendura, kush më shumë e kush më pak.

Mirëqenia ekonomike dhe sociale si dhe shpërndarja e drejtë e resurseve të kufizuara ka qenë, është, edhe do të jetë një prej qëllimeve kryesore të fushës së studimit të ekonomisë. Për krijimin e të mirave materiale, ekonomia vendase përdor shumë resurse dhe faktorë të ndryshëm ekonomik (lënda e parë, fuqinë punëtore, pajisjet e ndryshme maqinerike) me qëllim krijimin e të mirave dhe shërbimeve të ndryshme për kënaqjen e nevojave të popullatës, gjegjësisht konsumatorëve të saj. Si kusht themelor, për rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të ndryshme, ekonomitë vendase tentojnë që në orbitën e tyre t'i tërheqin faktorët më të mirë prodhues, bëjnë investime të ndryshme kapitale në maqineri, infrastrukturë, rrugë transportuese etj. vetëm e vetëm që produkti i tyre të dalë më i miri në treg dhe të ketë plasman në tregje të ndryshme botërore. Qëllimi kryesor, natyrisht është realizimi i profitit (fitimit).

Duke marrë parasysh ato që thamë më lartë nga njëra anë, dhe kufirin e mundësive të prodhimit të një vendi nga ana tjetër, vjen në pah “detyrimi” i një vendi që të kërkojë alternativa tjera në gjetjen e të mirave materiale dhe shërbimeve për kënaqjen e nevojave të popullatës (konsumatorëve) së saj. Kështu, krijohet edhe procesi i eksport-import të mallrave dhe shërbimeve midis dy apo më shumë vendeve. Në rastin tonë, Republika e Maqedonisë është mjaft aktive në këtë proces, edhe pse ka një bilanc të madh negative tregar, që do të thotë se më shumë importon sesa eksporton mallra dhe shërbime në nivel shtetëror.

Në një këndvështrim tjetër, shumë vende botërore në politikat dhe strategjitë e tyre ekonomike, kanë si qëllim tërheqjen e investimeve të huaja direkte në vendet e tyre, me qëllim kryesor rritjen ekonomike të vendit. Kjo dukuri sjell efekte positive edhe atë: rritjen e investimeve kapitale, rritjen e flukseve monetare, përmirësim të bilancit tregtar, përmirësim i tregut të brendshëm (sjellja e teknologjive të reja nga jashtë), nxitjen e konkurrencës së drejtë mes kompanive vendase dhe të huaja, avancim profesional të fuqisë punëtore (organizim i trajnimeve të ndryshme për përdorimin e teknologjive të reja) dhe ndikim në shumë aspekte tjera të jetës ekonomike të konsumatorit.

Republika e Maqedonisë është mjaft aktive në këtë aspekt, ku me anë të agjencioneve të ndryshme qeveritare, në tregun e jashtëm, promovon legjislaturën e saj tërheqëse për t'i joshur kompanitë e huaja që të investojnë kapitalin e tyre në vendin tonë. Kjo politikë ka patur sukses deri diku, pasi që efekti i këtyre veprimeve shihet në rritjen e numrin të ndërmarrjeve të huaja të cilat hapin kapacitetet e tyre prodhuese në vendin tonë por jo vetëm atë. Shumë kompani e shfrytëzojnë fuqinë tonë të lirë punëtore edhe në industri tjera si psh: në industrinë e komunikimeve (IT, Call Center, Outsourcing), industrinë e sigurimeve, financave, shërbimeve etj.

Duke parë rëndësinë e kësaj teme, vendosa që edhe unë të bëj një hulumtim më të thellë në këtë drejtim, duke analizuar disa faktorë ekonomike në përgjithsi, si dhe investimet e huaja direkte në veçanti, duke u fokusuar në ndikimin e tyre në eksport dhe rritjen ekonomike të Republikës së Maqedonisë dhe vendeve në tranzicion.

Andaj në vazhdim do t'i shkruaj disa hipoteza të këtij studimi që më vonë do të tentoj t'i vërtetoj në bazë të të dhënave që do t'i përdor:

- 1) HIPOTEZA ZERO#0: Investimet e huaja direkte nuk kane ndikim konsiderueshëm pozitiv në rritjen e eksportit të Republikës së Maqedonisë.
- 2) HIPOTEZA ALTERNATIVE # 1/1: Investimet e huaja direkte kane ndikim të konsiderueshëm pozitiv në rritjen e eksportit të Republikës së Maqedonisë.

Më pas, punimin do t'a vazhdoj duke bërë përshkrimin e kuptimit të investimeve të huaja direkte, efektin e tyre në variablat tjerë ekonomikë, shqyrtimin e literaturës së autorëve tjerë të cilët janë marrë me këtë problematikë, paraqitjen e të dhënave për Republikën e Maqedonisë dhe vendeve në tranzicion, analizën e të dhënave me modele ekonometrike si dhe interpretimin e rezultateve, me ç'rast, do të vërtetojmë apo do të hudhim hipotezat e paraqitura më lartë.



## I.2 Investimet e huaja direkte, kuptimi, efektet dhe rëndësia

Investimet e Huaja Direkte janë një segment shumë i rëndësishëm i aktivitetit ekonomik të një vendi, për shkak të efekteve që sjellin këto të fundit. Investimet e huaja direkte në Maqedoni janë konsideruar shpesh herë edhe si lokomotiva e vendit, meqënëse përqëndrimi i tyre ka qenë në sektorë të rëndësishëm të ekonomisë së saj. Në teori dhe në praktikë, njihen edhe efektet e investimeve të huaja direkte (IHD-ve). IHD-të kanë sjellë efekte pozitive në ekonomi, por pa dyshim kjo nuk do të thotë se ky punim do të trajtojë vetëm aspektet pozitive të IHD-ve, pasi që të njëjtat mund të kenë efekt të kundërt në një vend, duke demotivuar kështu kompanitë vendase prodhuese.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është analiza e anës teorike dhe lidhjeve që ajo sugjeron për IHD-të në tërësi. Një ndër lidhjet kryesore që teoria e paraqet, është ajo e lidhjes së IHD-së me rritjen ekonomike. Gjithashtu qëllim tjetër i këtij punimi është edhe pasja e një pamje të IHD-ve në Maqedoni ndër vite, sektorët kryesorë ku janë përqëndruar, rrethet/qytetet ku janë shpërndarë dhe kështu me rradhë. Por më vonë si qëllim i fundit mbetet edhe testimi i lidhjes së IHD-ve në vendin tonë me rritjen ekonomike, për të testuar vërtetësinë e lidhjes së tyre, duke parë nëse kjo lidhje është apo jo statistikisht e rëndësishme.

Struktura e këtij punimi ndahet në këto pjesë kryesore: si fillim tentohet të jepet një pikpamje teorike dhe të shihen definimet dhe lidhjet e IHD-ve me aspekte të ndryshme ekonomike. Së dyti është evoluimi në kohë dhe detajimi i IHD-ve në nivele të ndryshme, për shembull me vendet e origjinës, regjioni, monedha që më së shumti investohet, sektorët, etj. Së treti janë efektet që pasqyrohen në ekonomi nga vëllimi I investimeve të huaja në Maqedoni. Pra synohet në këtë pjesë të shikohet se cilat kanë qenë efektet më kryesore në vendin tonë. Më vonë, në vazhdim të strukturës, është edhe krahasimi i Maqedonisë në raport me vende tjera të rajonit dhe më gjërë, ku kryesisht janë vende të cilat janë në faza të tranzicionit.

Më pas do të vijojmë me një analizë empirike e lidhjes së IHD-ve me rritjen ekonomike dhe eksportin, ku me anë të paraqitjeve grafike dhe statistikore do të tentojmë të shpejgojmë këto dukuri, me qëllim që të kuptohet esenca e tyre dhe si t'i organizojmë politikat tona prodhuese dhe makroekonomike që të kemi sa më shumë përfitime, duke u bazuar gjithmonë në modelin ekonometrik që do t'a ndërtojmë.

Dhe në pjesën e fundit, do të paraqesim konkluzionet dhe mendimet tona në bazë të rezultateve që do t'i gjenerojmë nga analiza e të dhënave që do t'i paraqesim në vazhden e këtij punimi.

### 1.2.1 Këndvështrimi teorik i IHD-ve

Në këtë kapitull do të japim një këndvështrim të përgjithshëm mbi IHD-të duke filluar me definicionet e ndryshme dhe mbi etiketimin që i bëhet një IHD-je, dhe më pas mbi llojet e ndryshme të IHD-ve, dhe në fund duke dhënë një përfundim personal mbi teoritë e IHD-ve.

### 1.2.2 Definime të Investimeve të Huaja Direkte

Çështja e IHD-ve është një çështje me shumë rëndësi, jo vetëm në spektrin global, por në veçanti për vendin tonë, shpesh herë edhe e trajtuar si çështje politike. Por në këtë pikë është e rëndësishme të biem dakort edhe përsa i takon përkufizimit të tyre. IHD-të njohin shumë definime, shpesh herë edhe me pasoja për matjen e tyre, dhe kuptohet për shifra të ndryshme. Por koncepti që merret për bazë në këtë punim do të jetë një koncept më ndërkombëtar, si në vijim: ***“Investimet e Huaja Direkte sipas OECD<sup>1</sup> (2007), reflektojnë synimin e sigurimit të një interesi të qëndrueshëm të një njësie rezidente në një ekonomi (investuesi direkt), në një njësi rezidente të një ekonomie tjetër (ndërmarrja e investimit direkt). Koncepti i “interesit të qëndrueshëm”, nënkupton ekzistencën e një marrëdhënie afatgjatë midis investitorit direkt dhe ndërmarrjes, si dhe të një ndikimi të konsiderueshëm të investitorit në administrimin e procesit të vendimmarrjes në ndërmarrje. Indeksi i IHD-ve është i rëndësishëm në vendet në zhvillim, si dhe në ato të zhvilluara.***

IHD-të<sup>2</sup> kërkojnë një marrëdhënie biznesi ndërmjet shoqërisë « mëmë » dhe degës së saj të jashtme. Marrëdhëniet e jashtme të drejtëpërdrejta, japin një rritje të biznesit për korporatat multinacionale. Që një investim të konsiderohet si një IHD, shoqëria « mëmë » duhet të ketë të paktën 10% të aksioneve të zakonshme nga filialet e saj të jashtme. Firma investitore gjithashtu, mund të kualifikohet për investime të huaja në qoftë se zotëron fuqi të votimit në një ndërmarrje që vepron në një vend të huaj.

MNC-të (Multinational Cooperation), kompanitë shumëkombëshe i konkretizojnë mundësitë e tyre për biznesin e tyre me ndihmën e investimeve të huaja direkte (që nënkupton investimet në mjete reale apo të prekshme siç janë toka, ndërtesa, makineri etj., në vende të huaja). Megjithatë IHD-të kërkojnë investime thelbësore dhe të vazhdueshme, dhe një sasi e madhe e kapitalit mund të jetë e rrezikuar. MNC-të tentojnë të analizojnë mirë vendimet e tyre përpara se ato të zbatohen në çfarëdo lloj investimi të huaj direkt. Legjislacioni i Republikës së Maqedonisë për IHD-të, është i hapur në pikëpamjen e të drejtës së krijimit të shoqërive apo ndërmarrjeve të reja .

---

<sup>1</sup> <https://www.oecd.org/daf/inv/investmentstatisticsandanalysis/40193734.pdf>

<sup>2</sup> Oltjana Zoto – Investimet e huaja direkte ne Shqipëri, analizë e efekteve, politikave dhe lidhja me rritjen ekonomike

Ai i përmbahet parimit të trajtimit kombëtar sipas të cilit:

- *Shoqëritë e huaja janë objekt i procedurave pak a shumë të njëjta me ato që aplikohen për shoqërite vendase*
- *Nuk ka kufizime për hyrjen në sektorë të ndjeshëm si transporti dhe financa*

Gjithashtu IHD<sup>3</sup>-të mund të përcaktohen si :

“Investim që bëhet për të përfituar një interes të caktuar, për një periudhë të gjatë kohe në një ndërmarrje, e cila operon në një mjedis ekonomik ku investitori ia arrin qëllimit për të pasur rezultat në manaxhimin e saj. IHD-të paraqiten në forma dhe mënyra të ndryshme, si p.sh. blerja e asetëve (aktiveve) në një vend tjetër, transferimi i asetëve (aktiveve) në një vend tjetër, riinvestimi i fitimit në një vend tjetër”. Të gjitha këto janë metoda të investimit direkt.

Në rastin e blerjes së aksioneve, investimi direkt ndryshe nga investimi në portofol, përfshin përfitimin e mbajtjes së aksioneve të tilla të rëndësishme, të cilat të japin të drejtën e kontrollit, ose aftësisë për të marrë pjesë në manaxhimin e një firme.

Si një *investim direkt* konsiderohet një hua për një filial ose për një firmë “bijë”, ndërsa një hua për një firmë të palidhur me investitorin, ose blerja e aksioneve të një firme të palidhur me të, konsiderohet si *investim në portofol*.

Njihen dy lloje formash me të cilat investimet e huaja mund të realizohen nga njëri vend (vendi investues) në tjetrin, (pritësi). Kështu dallojmë *investimet e huaja indirekte*, të njohura ndryshe dhe si investime portofoli, të cilat janë investime që kryhen me anë të kanaleve financiare ekzistuese mes vendit investues dhe atij pritës. Ndërkohë që mënyra e dytë është ajo e *investimit të huaj direkt*.

*Sipas përkufizimit klasik*<sup>4</sup>, IHD konsiderohet një kompani e një vendi të caktuar që bën një investim fizik duke ndërtuar një ndërmarrje apo firmë industriale të çfarëdoshme në një vend tjetër.

Përcaktuesi “direkt” vjen nga fakti se investimi kryhet në formë të drejtpërdrejtë nëpërmjet ndërtimit të ndërtesave dhe prurjes së makinerive, përveç prurjes së kapitalit. Në një farë mënyre, kur themi “direkt” nënkuptohet fjala “fizik”, pra një investim i prekshëm dhe i dukshëm.

Por qëllimi ynë nuk është të ndalemi dhe të përshkruajmë dallimet e ndryshme që shumë autorë në punimet e tyre kanë dhënë në librat apo punimet e tyre në definimin e IHD-ve, por fokusi ynë do të jetë në analizën e efekteve që japin IHD-të në sferën ekonomike.

Rritja e shpejtë ekonomike që disa vende në zhvillim kanë pësuar dhe ndryshimet në rrjetin global të investimeve, ka bërë që përkufizimi i IHD-ve të zgjerohet akoma më tepër në mënyrë që të përfshijë edhe nocione të reja.

---

<sup>3</sup> Jeff Madura-Drejtimi Financiar Ndërkombëtar, Investimet e Huaja Direkte.

<sup>4</sup> International Business: A Strategic Management Approach, Alan M. Rugman, Richard M. Hodgetts, 1995

### 1.2.3 Klasifikime të Investimeve të Huaja Direkte

Nuancat e IHD-ve kanë marrë trajta të ndryshme duke u klasifikuar në pesë lloje<sup>5</sup>.

- **Lloji i parë** ka të bëjë me ato IHD që përdoren për të fituar akses në faktorët specifikë të prodhimit, të tilla si resurset, njohuritë teknologjike, patentat ose emri i mirë që zotërohet nga një kompani në vendin pritës. Ky rast zbatohet kur asete të tilla janë të vështira të transferohen ose nuk gjenden në vendin e origjinës së investimit.
- **Lloji i dytë** përfshin IHD-të të cilat kryhen për të fituar akses në faktorët më të lirë të prodhimit, si p.sh. “fuqia punëtore”. Studimi mbi këtë lloj IHD-je i atribuohet Raymond Vernon në teorinë e tij të Ciklit të Produktit. IHD-të e tilla inkurajohen shumë nga qeveritë e vendeve pritëse në rastin kur ato zbatojnë politika nxitëse në favor të eksporteve, duke i favorizuar ato me anë të taksave ose granteve të ndryshme. Nëse qeveria është e orientuar drejt minimizimit të importeve, atëherë kompanitë e huaja mund të operojnë nëse kanë asete që firmat vendase nuk i zotërojnë. Ky rast nuk i përket Maqedonisë, pasi siç dihet vendi ynë ka një varësi shumëvjeçare ndaj importeve, pavarësisht se trendi i eksportimeve ka pësuar një rritje të ndjeshme gjatë viteve të fundit, (Burimi: INSTAT & Agjencioni për investime të huaja në Republikën e Maqedonisë).
- **Lloji i tretë** i IHD-ve lidhet me firmat që konkurojnë në rang ndërkombëtar duke ndërmarrë një sërë investimesh në vendet që i konkurojnë. Këtë e realizojnë përmes formës së organizimit të joint venture\* në mënyrë që të fitojnë akses në rangjet e produkteve të njëra-tjetrës. Ky lloj IHD-je është përhapur shumë si pasojë e rritjes së konkurrencës mes produkteve të ngjashme dhe arritjeve në kërkim-zhvillim. Një rast i tillë mund të jetë ai i kompanisë shqiptare leader të aluminit, “PESPA AL”, e cila ka kryer IHD në vende fqinje si Itali, Bosnje Hercegovinë dhe Maqedoni (site i Pespa AL).
- **Lloji i katërt** ka të bëjë me IHD-të që synojnë aksesin tek konsumatorët e vendit pritës. Në këtë lloj IHD-je përpjekja është sigurimi i të gjitha produkteve dhe shërbimeve për konsumatorët pritës njëlloj si i ofrojnë ato për konsumatorët e vendit investues. Kjo shpesh rezulton gati të jetë e pamundur për shkak të shërbimeve të caktuara ose të paafësisë për të përmbushur një lloj kërkese të caktuar. Pamundësia e tregtimit të disa produkteve e shërbimeve në vendet pritëse, ka qënë një faktor thelbësor në rritjen e këtij lloj IHD-je. Këtu mund të përmendim kompanitë celulare T-Mobile ose VIP, të cilat në pak kohë kanë arritur që të ofrojnë në Maqedoni të njëjtat shërbime celulare që ofrojnë edhe në vendin e tyre bazë, Gjermani dhe Austri.

---

<sup>5</sup> Internationalisation Strategies , G. Chrysochoidis, Millar Clegg, 1997

- **Lloji i pestë** dhe i fundit i IHD-ve lidhet me aspektin e tregtimit të diversifikuar të integritimit rajonal. Ky lloj shfaqet kur vendi pritës paraqet avantazhe lokale për kompanitë e huaja që duan të investojnë për të fituar akses në tregun e pritësit. Por barrierat e taksimit dhe të tregtimit, pengojnë këto kompani të eksportojnë të mira e shërbime në këto vende. Kur e konsiderojnë të arsyeshme, kompanitë e huaja kapërcejnë këto barrierat duke themeluar praninë e tyre në vendin pritës me qëllim që të fitojnë pjesë në treg.

IHD-ja është një zë i ri i ekonomisë së shek. XXI i cili ka tendencën të ndërkombëtarizojë biznesin dhe tregtinë, duke sjellë përfitime të dyanëshme, si për investuesin ashtu dhe për pritësin.

Teoria njih disa forma të IHD-ve të cilat janë si më poshtë:

- **Marrja (përfitimi) ose shkrirja me një ndërmarrje në një vend tjetër** - Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me një ndërmarrje në një vend tjetër Krijimi i një ndërmarrje të re (investim në fushë të gjelbër)
- **Investime shitesë ose riinvestim në një projekt ekzistues**

Përveç formave të mësipërme ka aktivitete të tjera të tilla si: *teknologjitë e licënuara, operatorët e nënkontraktuar, ose formimi i aleancave të biznesit* që mund të klasifikohen ose jo si IHD, por që sigurisht mund të konsiderohen si të lidhura me IHD-të.

Investimet mund të klasifikohen dhe në bazë të qëllimit të investimit në një vend të huaj edhe atë:

- **IHD-të kërkuese të tregut** - synojnë të zhvillohen dhe të zgjerohen duke penetruar në tregjet e huaja, qëllim ky që arrihet duke përdorur strategjikisht blerjet dhe shkrirjet midis kompanive.
- **IHD-të kërkuese të burimeve dhe faktorëve të lirë të prodhimit** që disponojnë vendet e tjera të tilla si forca e punës, teknologji, ambjente pune, etj, duke arritur kështu uljen sa më shumë të kostos së prodhimit të tyre. Këta lloj investitorësh janë tipikë për vendet në zhvillim si vendet e Evropës Juglindore.
- **IHD-të kërkuese të eficiencës** - përdorin zgjerimin në vende të huaja për të përfituar nga ekonomitë e shkallës, diversifikimi i aktiveve dhe i riskut, tipike kjo për vendet e zhvilluara si p.sh. ato të BE-së.

Disa ekonomistë si *Caves, Kojima dhe Narula*, kanë dhënë mënyrat e tyre të ndarjes së IHD-ve nga këndvështrimi i investitorit (vendi i origjinës së IHD-së).

Caves i ndan IHD-të në: *horizontale, vertikale dhe konglomerat (Caves 1971).*

- **IHD-të horizontale** - kanë si qëllim prodhimin e produkteve të njëjta ose të ngjashme me ato që prodhohen në vendin e origjinës.

- **IHD-të vertikale** nga ana tjetër, konsistojnë në ndarjen gjeografike të fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit. Kështu pra, nxitet tregtia përtej kufijve (brenda kompanisë), dhe rritet mundësia e degëve për të eksportuar.
- **IHD-të konglomerat** mund të jenë një përzjerje e investimeve horizontale dhe vertikale, të cilat përfshijnë edhe investimin në një industri të një natyre tjetër në vendin pritës.

Të tjera forma të IHD-ve të cilat nuk kanë të bëjnë me transferim kapitali dhe që luajnë rol në zhvillimin ekonomik të vendit pritës janë: *nënkontraktimi, liçensimi, marrëveshjet franshize*, etj.

#### *1.2.4 Lidhja e Investimeve të Huaja Direkte me variabla të tjerë ekonomikë*

IHD-të përfaqësojnë një variabël ekonomik shumë dinamik sidomos pas viteve 1990, por lëvizjet e konsiderueshme filluan para viteve 1980. IHD-të zënë rreth  $\frac{1}{4}$  e lëvizjeve ndërkombëtare në të gjithë botën (Eustat 2000). Kjo lëvizje e vrullshme e IHD-ve ka ardhur si rezultat i konkurrencës ndërkombëtare, si dhe nga heqja e pengesave në tregjet e produkteve (mallrave dhe shërbimeve), gjithashtu prezente edhe në tregjet e faktorëve dhe ato financiare. Në shumë raste, konsiderohet (Jones 1996), se avantazhi konkurues i disa vendeve në zhvillim, ka bërë që IHD-të të ndryshojnë kahje, sic është rasti i pagave të ulëta kryesisht në vendet në zhvillim. Por vërehet se IHD-të vazhdojnë ciklin e tyre të rritjes, pavarësisht uljes së flukseve të tregtisë ndërkombëtare (Jeon 1992 dhe Moore 1993).

##### ***Avantazhet që ofrojnë IHD-të***

Në rradhë të parë, IHD-të të japin përshtypjen se ato ndikojnë në humbjen e identitetit ekonomik vendor, pasi që në thelb, IHD-të për baze kanë kapitalin e huaj (paratë apo mjetet që investohen në një vend që prejardhja apo vendi i origjinës nuk është i njëjtë me vendin ku destinohen këto mjete). Por kjo pikëpamje, është paksa nacionaliste dhe mund të ndikojë negativisht në tërheqjen e këtij kapitali i cili është më se i nevojshëm, sidomos për Republikën e Maqedonisë.

Qëndrimi tjetër përse i takon IHD-ve është edhe se shpesh nga pikëpamja teorike ato shihen si një kanal mundësish, veçanërisht për vendet në zhvillim. Sipas Lipsey (1999), IHD-të janë burimi më kryesor dhe dinamik në tërësi për investimet e një vendi në zhvillim. Pavarësisht kësaj, flukset e IHD-ve nuk duhen parë vetëm në këndvështrimin e një fluksi të vetëm, por i shumë flukseve pasuese të fluksit fillestar të kapitalit. Konkretisht përveç investimit fillestar, IHD-të pasohen nga lëvizje ndërkombëtare kapitali, nga vendi pritës te ai i origjinës, nga lëvizje e aftësive menaxheriale, teknologjike e kështu me rradhë.

IHD-të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në transformimin e vendeve, veçanërisht atyre post-komuniste (Moose 2000). Në ndryshimin e strukturës, nënkuptojmë përparimin dhe

hapjen e ekonomisë nga pikëpamja ndërkombëtare dhe orientimin në avantazhet konkurruese si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Një nga përparësitë e IHD-ve është se ato ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të vendit ku derdhen investimet.

IHD-të zakonisht gjejnë zbatim në vendet në zhvillim. Gjatë viteve '90-të, ato ishin një nga burimet kryesore të financimit të jashtëm për shumicën e vendeve që kishin një prespektivë rritjeje ekonomike. IHD-të gjithashtu kanë ndihmuar disa vende kur ato janë përballur me vështirësi ekonomike.

IHD-të gjithashtu lejojnë edhe transferimin e teknologjive e cila është bërë kryesisht në mënyrë të sigurimit të inputeve kapitale. Vendet që kanë marrë IHD nga një vend tjetër mund të zhvillojnë resurset humane të tyre, duke punësuar njerëz të rinjë në veprimtarinë e ndonjë biznesi të veçantë. Fitimet që gjenerohen nga IHD-të të cilat janë bërë në atë vend, mund të përdoren për qëllim kontributi për taksat mbi të ardhurat e korporatave të vendit marrës.

IHD-të ndihmojnë në krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e pagave të punëtorëve, lehtësimin e mënyrës së jetesës etj. Investimet e huaja direkte zakonisht kontribuojnë në zhvillimin e sektorit prodhues të vendit pritës të investimeve.

IHD-të luajnë një rol vendimtar në kontestin e rritjes së produktivitetit të vendeve pritëse. Kompanitë e këtyre vendeve kanë mundësi të eksplorojnë tregje të reja, të huaja dhe në këtë mënyrë të gjenerojnë më shumë të ardhura dhe fitime. Lehtësojnë aksesin në tregje të reja dhe kështu mund të kontribuojnë në rritje e eksporteve dhe të të ardhurave prej tyre.

IHD-të janë një burim për financimin e deficitit në Bilancin e Pagesave duke përmirësuar kreditimin në vendet pritëse.

IHD-të luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e kushteve të duhura ekonomike për anëtarësimin në BE.

Disavantazhet e investimeve të huaja direkte janë gjithashtu ana tjetër e medaljes. Ato ndodhin kryesisht në rastin e çështjeve që lidhen me funksionimin dhe shpërndarjen e fitimeve nga investimet e huaja. Një nga disavantazhet jo të drejtpërdrejta të IHD-ve është se sektorët ekonomikë më pak të zhvilluar të vendit pritës janë gjithmonë të papërshtatshëm kur niveli i IHD-ve ndikon në mënyrë negative.

Situata të ngjashme në vende si Irlanda, Kili, Singapori dhe Kina konfirmojnë një mendim të tillë. Është shumë normale që vendi pritës të ketë përgjegjësi për të kufizuar shkallën e ndikimit të IHD-ve. Këto vende duhet të jenë të sigurtë që subjektet të cilat realizojnë IHD në vendin e tyre, duhet t'i përmbahen mjedisit, qeverisjes, rregullave sociale, të cila janë të përcaktuara dhe funksionojnë në atë vend.

IHD-të përmbajnë në vetvete shpenzime të larta të komunikimit, udhëtimit, etj. Dallimet në gjuhë dhe kulturë që ekzistojnë midis vendit investues dhe vendit pritës, mund të paraqesin gjithashtu pengesa në rastin e IHD-ve. Megjithatë një disavantazh i IHD-ve është se ekziston gjithmonë mundësia e dështimit në pronësinë e një kompanie që ka kompani jashtë. Kjo ka bërë shpesh që shumë kompani t'i afrohen IHD-ve me një kujdes të lartë. Disa herë është vënë re se ka

paqëndrueshmëri të konsiderueshme në një rajon të caktuar gjeografik e cila shkakton shumë shqetësim për investitorin e huaj, risku politik.

Madhësia e tregut, si dhe kushtet e vendit pritës mund të jenë faktorë të tjerë të rëndësishëm për IHD-të. Në rastet kur vendi pritës nuk është i lidhur fort me vendet më të avancuara fqinje, kjo përbën sfidë për investitorët. Disa herë është vënë re se qeveritë e vendit pritës kanë patur probleme me IHD-të kjo pasi qeveria e vendit pritës ka më pak kontroll mbi funksionimin e kompanive të cilat janë degë në pronësi të plotë të një kompanie jashtë vendit.

Por të gjitha këto klasifikime ndërkombëtare të investimeve të huaja direkte kanë ndikimet e tyre në ekonomi, ndikime me efekte pozitive por edhe negative.

Efektet e IHD-ve ndahen në:

1. *Efekte ekonomike*
2. *Efekte politike dhe sociale.*

Sipas parimeve të ekonomisë neoklasik<sup>6</sup>, IHD-të rrisin mirëqënien e vendit pritës, nën disa kushte optimale, siç janë maksimizimi i fitimit të kompanisë ndërkombëtare si dhe pasja e avantazhit konkurrues në vendin që investohet, në sensin e inputeve dhe çmimeve të tyre.

### **Efektet makroekonomike të IHD.**

Efektet ekonomike mund të shihen si në *këndvështrimin mikroekonomik* ashtu edhe në atë *makroekonomik* duke prekur variabla si outputi/prodakti i një firme, por edhe i gjithë vendit, bilanci i pagesave dhe madje edhe struktura e tregut. Teoria njih se ardhja e kompanive të huaja direkte mund të përmirësojë konkurrencën ose mund edhe ta përkeqësojë atë duke tentuar në forma jo-konkurrenciale, për shkak të pozitës dominuese të tyre.

Por këndvështrimi më *kryesor është ai makroekonomik*, i lidhjes së IHD-ve me outputin/prodaktin e përgjithshëm, pra me rritjen ekonomike të vendit pritës.

Teoritë e rritjes dhe të zhvillimit ekonomik fokusohen në rritjen e të ardhurave reale për frymë dhe e lidhin këtë variabël me shumë faktorë të tjerë si akumulimi i kapitalit, rritja e popullsisë, progresi teknologjik dhe zbulimi i burimeve të reja natyrore.

Sidoqoftë, ndër këto si faktori drejtues i rritjes dhe zhvillimit ekonomik të vendit pritës, evidentohet akumulimi i kapitalit.

Konkretisht teoria e rritjes endogjene nënvizon efektet nga eksportet si faktor i cili ndikon në vendosjen e një rritje ekonomike të qëndrueshme dhe afatgjatë, duke lejuar inovacione teknologjike dhe dinamike nga jashtë, veçanërisht nga vendet e origjinës së IHD-ve (Lucas, 88, Romer 86, 89, Grossman and Helpman , 91 Edçards, 92).

IHD-të shihen si një ndër përfituesit më potencial të rritjes ekonomike veçanërisht për vendet në tranzicion<sup>7</sup> dhe disa herë nevojiten për t'i dhënë një hov rritjes ekonomike të një vendi.

---

<sup>6</sup> Foreign Investment, transnationals and developing countries, Sanjaya Lall and Paul Streeten, 1977

<sup>7</sup> The impact of FDI o Growth in Developing Countries: An African Experience, Adewumi S, 2006



IHD-të mund të ndihmojnë vendin pritës veçanërisht në transferimin e teknologjisë, dhe përdorimin e saj edhe për investimet e brendshme, transferimin e know-how dhe aftësive menaxheriale apo profesionale.

Në studimin e tij Krkoska (2001), thekson edhe rëndësinë e spillover në ekonominë e vendit pritës, dhe zëvendësimin e kapitalit të zhvlerësuar të atij vendi me kapitalin e ri të investimeve të huaja direkte, i cili sjell edhe rritjen e produktivitetit të vendit pritës. Por një efekt tjetër i IHD-ve është edhe rritja e flukseve të “R&D” kërkim-zhvillimit në vendin pritës dhe qarkullimi i tyre edhe në kompani të tjera.

Literatura, nënvizon gjithashtu edhe efektet e IHD-ve në tregtinë ndërkombëtare<sup>8</sup> (Markusen, 1998). Kjo gjë shihet nga pikëpamja jo vetëm e intensifikimit të flukseve të tregtisë ndërkombëtare nga vendi pritës në pjesën tjetër të botës, por edhe me atë të përdorimit të avantazheve konkurruese të vendeve të ndryshme. Pra rritjen e tregtisë ndërkombëtare dhe shpeshherë edhe rritjen e cilësisë si dhe uljen e kostos së produkteve, për pasojë çmimet e tyre.

Në vazhdim të kësaj teorie, konkludohet se disa investime janë më mirë nëse qëndrojnë nën menaxhimin e huaj, duke qënë se kështu ka më pak ndërhyrje nga qeveria. Ajo shihet më së shumti si problem i vendeve emergjente dhe atyre në zhvillim, dhe për pasojë nga ana tjetër kompanitë ndërkombëtare paraqiten si më të pavarura nga pikëpamja e pronësisë por edhe e menaxhimit. Përveç këtyre impakteve pozitive të përmendura këtu, njihen edhe impakte negative, siç u parapri edhe në paragrafet më parë. Por për ta lidhur me rritjen ekonomike, si impakte negative njihen ato të lëvizjes së kapitalit dhe kthimit të tij në vendin e origjinës, madje edhe efektet negative mbi mjedisin, apo rritjen e fuqisë në një vend dhe ndikimi i politikave dhe vendimeve qeveritare<sup>9</sup> (Jones 1996).

Ky punim përgjithësisht do të fokusohet në IHD-të në veçanti në lidhjen e këtyre të fundit me rritjen ekonomike. Rritja ekonomike matet me rritjen e GDP-së, dhe në këtë mënyrë në korrelimin e këtyre të fundit, por meqënëse si efekte në përmendëm edhe tregtinë ndërkombëtare, atëherë do shihet edhe eksporti dhe riekporti.

Teoria në këtë këndvështrim lidh në mënyrë pozitive dhe të rëndësishme dy variablat kryesorë, pra kur vlerat e larta të investimeve të huaja direkte shoqërohen me vlera të larta të rritjes ekonomike. Përveç aspekteve pozitive, teoria për këtë lidhje shfaq edhe skepticizmin e saj. Konkretisht Alfaro (2003), nënvizon se flukset e IHD-ve, veçanërisht në sektorin manifakturor mund të kenë edhe efekte jo-pozitive, pra ose negative ose pozitive jo të rëndësishme. Ndërkohë për sektorin e shërbimeve efektet shpeshherë janë të papërcaktuara dhe jo të qarta. Për vendet në tranzicion korrelacioni i IHD-ve me rritjen ekonomike është statistikisht i paqartë (Lyroydi et al, 2004) dhe (Stanisic and Jankovic, 2007).

---

<sup>8</sup> Multinational firms, Location and Trade, James R. Markusen, 1998

<sup>9</sup> Oil and the Stock Markets, Charles M. Jones, Gautam Kaul, 1996

Përvec efekteve makroekonomike, teoria (Moose, 2001) njih edhe efekte në punësim dhe në paga. Konkretisht:

Rrisin në mënyrë direkte punësimin duke vendosur ndihma të reja, ose në mënyrë indirekte duke stimuluar punësimin sipas alokimeve të ndryshme. Pra, punësimi mund të rritet në fusha të ndryshme, ashtu edhe në qytete të ndryshme.

Mund të ruajnë punësimin veçanërisht nëse investimet bëhen në ndërmarrje ekzistuese në pragje krizash, falimentimi, etj. pra të “sëmura”, duke ristruktuar apo përvetësuar këto lloj kompanish.

Investimet e huaja direkte mund të ulin punëzënieën nëpërmjet disinvestimeve dhe kufizimeve të lehtësirave/faciliteteve në prodhim.

Gjithsesi evidencat praktike tregojnë se ndikimi i IHD-ve në punësim është i ulët. Vaitos (1976), analizoi efektet e kompanive shumëkombëshe përsa i përket shkallës, përqëndrimit dhe transnacionalitetit. Ai konkludoi se trajnimi i punonjësve lokalë të një vendi është me rëndësi thelbësore për suksesin e kompanisë, por që gjithsesi janë kosto që nuk kanë kthyeshmëri.

Por së fundmi, por jo nga rëndësia vlen të ripërmenden efektet e investimeve të huaja direkte në produktivitet. Siç nënvizuam në paragrafet e mësipërme IHD-të tentojnë në përgjithësi të rrisin produktivitetin dhe të ulin koston për njësi nëse:

Janë promovues të eksportit dhe destinohen për një treg global shumë të gjërë, nga ku mund të krijohen ekonomizime të shkallës

Kushtet dhe politikat lejojnë instalimin e planeve të projektuara për të arritur ekonomizime të plota shkalle

Por të gjitha këto efekte agregohen nga ana teorike në një lidhje empirike të IHD-ve me këto efekte. Modelimi i efekteve të IHD-ve njih shumë përjasje. Shumë nga efektet e tyre të përcaktuara edhe më parë nga këndvështrimi teorik, modelohen me anë të një ekuacioni të përgjithshëm duke ndërtuar në këtë mënyrë seri kohore për periudhën e marrë në studim. Si variabël i pavarur kuptohet që merret variabli i IHD-ve, për të parë se cilat janë ato efekte që ndikojnë dhe masa e ndikimit të tyre në IHD. Borensztein et al (1995), sugjeron përdorimin e ekuacionit të poshtëshënuar:

$$g = f(I^F, H, Y_0, X)$$

Ku  $g$  = norma e rritjes

$I^F$  = investimet e huaja direkte

$H$  = stoku i kapitalit Human

$Y_0$  = niveli fillestar i outputit/produktit të përgjithshëm të vendit

X = vektori i faktorëve që ndikojnë në rritjen ekonomike si shpenzimet qeveritare, kufizimet tregtare, kursi i këmbimit, etj. Ndërkohë në literaturë zgjidhet e njëjta formë funksionale-regresive, por duke pjestuar cdo variabël me GDP-në e një vendi.

### I.3 Shqyrtimi i literaturës

Studimi nga **Guido Candela & Massimiliano Castellani & Maurizio Musson (2012)** analizojnë politikat e investimeve në destinacionet turistike dhe arrijnë në konkluzion duke përdorur tre politika: nuk ka ndërhyrje (*laissez faire*), tatimet dhe politika e përkohshme e detaksave.

**Piotr Bialowolski dhe Dorota Weziak-Bialowolska** këtu autorët bënë përpjekje për të hetuar rëndësinë e faktorëve të jashtëm në vendimet investive të bëra nga kompanitë polake. Me përdorimin e disa të dhënave ata kanë (1) shqyrtuar faktorët që ndikojnë në vendimet investive të kompanive në Poloni; (2) të vlerësojë lidhjen ndërmjet degës, madhësinë e kompanisë dhe faktorët e investimeve; (3) të vlerësojë rëndësinë e faktorëve të investimeve; dhe (4) të përcaktoj ndikimin relativ të këtyre faktorëve në nivel në reduktimet e investimeve.

Së pari, ata analizojnë periudhën e pagesave që janë aplikative në shtetin përkatës dhe ndikimin e tyre në vendimet investive të kompanive të ndryshme. Së dyti në mesin e treguesve të përzgjedhur për vlersimin e vendimeve investive, dy forcat lëvizëse që përcaktojnë vendimet investive të kompanive polake si: faktorët makroekonomik dhe faktorët ligjor të lidhura me rëndësinë relative që ishte më e ulët se e fundit. Së treti ka një lidhje pozitive në rëndësinë e të dy faktorëve dhe reduktimeve aktuale të investimeve, duke lënë të kuptohet se kompanitë që përballen me reduktime të larta, rëndësia e faktorëve makroekonomik dhe faktorëve ligjor të lidhura është më I lartë.

**Heinz Hollenstein dhe Martin Berger (2015)** analizojnë ndikimin e investimeve të huaja në performancën e firmave në Zvicër dhe Austri dhe nëpërmjet modelit të Heckman dhe OLI ata vijnë në konkludim se investimet e huaja direkte kanë impakt pozitiv në performancën ekonomike të ndërmarrjeve zvicerane se sa ato austriake. Këtë lloj diference e arsyetojnë me vetë faktin se Zvicra ka pranuar më shumë “internacionalizma” ekonomikë, duke aluduar kështu në praninë e investitorëve të shumtë të huaj dhe flukset e valutave të ndryshme të cilat depozitohen në arkat e bankave që gravitojnë në Zvicër.

**Junaid Ahmed dhe Inmaculada Martínez-Zarzoso (2016)** ky është studimi I parë që shqyrton ndikimin e kostove të transaksioneve në remitancat e huaja. Këta studiues analizojnë se efekti I kostove të transaksioneve mbi flukset e remitancave është negative dhe signifikante, duke sugjeruar se një kosto e larte ose do ti përmbajë emigrantët për të dërguar para në shtëpi ose ti bëjnë ata ti dërgojnë përmes kanaleve joformale.

**Sasi Iamsiraroj and Hristos Doucouliagos (2015)** nga rezultatet e tyre kanë aritur në përfundim se mesatarisht rritja ekonomike është përcaktuesi më i rëndësishëm i IHD-ve.

**Ismail Aktar & Latif Ozturk & Nedret Demirci** analizojnë ndikimin e investimeve të huaja direkte në eksport, në rritjen ekonomike dhe investimet fikse totale për papunesinë në Turqi për periudhën 1987-2007. Me anë të teknikës së kointegritit të Johansen-it, rezultatet empirike tregojnë se ekzistojnë dy vektorë kointegrues përgjatë periudhës e cila analizohet.

**Shiva S. Makki** investimet e huaja direkte (FDI) dhe tregtia janë parë shpesh si katalizatorë të rëndësishëm për rritjen ekonomike për vendet në zhvillim. FDI është një mjet i rëndësishëm të transferimit të teknologjisë nga vendet e zhvilluara në vendet në zhvillim. FDI gjithashtu stimulon investimet e brendshme dhe lehtëson përmirësimet e kapitalit human dhe institucioneve në vendet pritëse. Tregtia ndërkombëtare është njohur të jetë një instrument i rritjes ekonomike. Analiza është bazuar në disa të dhëna të një mostër prej 66 vendeve në zhvillim më shumë se tre dekada, tregon se IHD dhe tregtia kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme në drejtim të avancimit të rritjes ekonomike të vendeve në zhvillim. Sipas analizave tregon se IHD ndërvepron pozitivisht me tregtin dhe stimulon investimet e brendshme si politikat makroekonomike, stabiliteti institucional.

**Nuzhat Falki (2009)** IHD ndikon në rritjen ekonomike duke nxitur investimet e brendshme, duke rritur formimin e kapitalit njerëzor dhe duke lehtësuar transferimin e teknologjisë në vendet pritëse. Qëllimi kryesor i studimit është të hetojë ndikimin e IHD-ve në rritjen ekonomike në Pakistan, për periudhën 1980-2006. Marrëdhëniet në mes të IHD-ve dhe rritjes ekonomike është analizuar duke përdorur funksionin e prodhimit të bazuar në variablën endogjen; variabla të tjerë që ndikojnë në rritjen ekonomike të tilla si tregtia, kapitali vendas dhe i punës janë përdorur dhe rezultatet e studimit tregojnë një lidhje negative dhe statistikisht të parëndësishme në mes të PBB-së dhe IHD për hyrjet në Pakistan.

**Dr. Sauwaluck Koojaroenprasis** - Qëllimi i këtij punimi është që të shqyrtojë ndikimin e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në rritjen ekonomike në Korenë e Jugut. Në këtë studim janë përdorur të dhënat sekondare dhe përfshin periudhën kohore prej 1980-2009. Ky studim përqipet për të përcaktuar ndikimin empirik të IHD-ve në ekonominë e Koresë së Jugut duke përdorur të dhëna makroekonomike në seri kohore vjetore. FDI, investimet e brendshme, punësimi, eksporti dhe kapitali human konsiderohen si variablat endogjene për rritjen ekonomike. Ky studim zbulon se ka një lidhje të fortë dhe positive të IHD-ve në rritjen ekonomike të Koresë së Jugut.

**Samuel Ebenezer, Fifi Emire, Xicang Zhao** theksojnë se investimet e huaja direkte (IHD) kanë qenë një burim vital i rritjes ekonomike për Ganën, duke e çuar në kryeqytetin e investimeve, teknologjisë dhe njohurive të menaxhimit të nevojshme për rritjen ekonomike. Ky punim synon për të studiuar marrëdhëniet në mes IHD-ve dhe rritjen ekonomike në Gana për periudhën 1980-2010, duke përdorur të dhënat në seri kohore. Qëllimi i këtij studimi është për të përcaktuar shkallën në të cilën këto variabla janë të lidhura. Nga kjo mund të konkludojmë se variabla të pavarura GDP, GDPg, GNI, MVA, GDPc dhe ART janë të gjithë të rëndësishëm për të shpjeguar IHD që nga viti tyre përkatëse p-vlera e t-statistika janë më pak se 5 për qind dhe në këtë mënyrë të ketë një ndikim të IHD-ve në Ghana.

**Zenegnaw Abiy Hailu** objektivi kryesor i këtij studimi është që të përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet IHD dhe bilancit tregtar (import dhe eksport) të vendeve afrikane për periudhën 1980 deri 2007. Për shkak të heterogjenitetit të dhënave, mos vazhdimësisë dhe për shkak se testi Hausman favorizon atë mbi teknikën e Random Effect, metoda e regresionit përdoret për të studiuar këto dukuri. Elasticiteti I eksportit dhe importit janë pozitive dhe të rëndësishme me elasticitetet e mëdha vërejtur për eksportet në raport me importet. Kjo nënkupton se Kompanitë Multinacionale (KMN) nuk janë vetëm të orientuara nga eksporti, por edhe janë të varura nga importi. Për të ruajtur rezervën e pakët të huaj, hartuesit e politikave të investimeve në këto vende duhet të drejtojnë Kompanitë Multinacionale drejt atyre fushave që përfshijnë promovimin e mëtejshëm të eksportit, zëvendësimin e importit dhe faktorit vendor intensiv investimet.

**Magdalena RĂDULESCU, Luminița ȘERBĂNESCU**, Pas vitit 1990, vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore (EQL) I kanë ulur pengesat për IHD. Natyrisht, shumë zhvillime të tjera janë duke u zhvilluar në të njëjtën kohë: në rritje është hapja ndaj tregtisë, privatizimi i parë I prodhimit në pronësi të qeverisë, si dhe shumë ndryshime të tjera si këto vende kanë lëvizur në shkallë të ndryshme nga ekonomia socialiste në të tregut dhe qeveritë demokratike. Ata privatizuan shumë ndërmarrje shtetërore, e nënshkruan marrëveshjet e tregtisë së huaj me vendet e tjera në rajon, dhe në përgjithësi kanë arritur një nivel të rëndësishëm të stabilitetit makroekonomik me përmirësimin e rritjes së normave. Ata gjithashtu përjetuar një rritje të konsiderueshme në investimet e huaja direkte. Si pasojë, raporti i IHD në vendet e EQL që kanë studiuar në gjithsej IHD-të botërore flukset hyrëse janë rritur më shumë se tre-fish. Gjatë së njëjtës periudhë, këto vende kanë arritur edhe një rritje të konsiderueshme në eksportet e tyre, sidomos në drejtim të Europës Perëndimore. Ata paraqesin në këtë punim lidhjen ndërmjet IHD-ve dhe Eksporteve në vendet e EQL gjatë 1990-2010 duke përdorur analiza statistikore të të dhënave dhe literaturës dhe nënvizojnë faktorët që kanë përcaktuar një rritje për eksportet në këto vende.

**Muhammad Bilaëal Muhammad Ibrahim, Amjad Abbas, Muhammad Shuaib, Mansoor Ahmed, Iltaf Hussain, Tehreem Fatima** qëllimi I këtij hulumtimi ishte për të hetuar nëse pasiguria apo luhajtjet në kursin e këmbimit ndikojnë në makeoekonominë e Pakistanit, ky studim është bazuar në të dhënat sekondare dhe seri kohore. Për këtë qëllim të dhënat e kursit të këmbimit dhe investimet e huaja direkte për periudhën e vitit 1982 deri në vitin 2013 janë përdorur dhe janë mbledhur nga faqja e internetit të Bankës së Shtetit të Pakistanit. Rezultatet treguan se ka një lidhje sigifikante pozitive në mes kursit të këmbimit dhe investimeve të huaja direkte në analizën e regresionit ku vlera e R-square është 67% dhe tregon se modeli I hulumtuar është I saktë.

**Bedassa Tadesse dhe Elias K. Shukralla** Duke përdorur të dhëna mbi rezervat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) nga 131 vende që përfshin vitet prej 1984 deri 2004 dhe numri i produkteve të eksportuara nga secili vend, ata shqyrtojnë efektin e IHD-ve në diversifikimin horizontal të eksportit. Për të matur efektet, ata shfrytëzojnë parametra (quantile) dhe metodat gjysmë parametrike ekonometrike. Rezultatet nga të dyja qasjet tregojnë se, në përgjithësi, rritja e stokut të IHD-ve rrit diversifikimin horizontal i eksporteve. Madhësia aktuale e efektit, ndryshon në masë të madhe në të gjithë vendet në varësi të stokut ekzistues të IHD dhe fazë të diversifikimi, duke i dhënë të rritet në një marrëdhënie pothuajse përmbysur U-formë. Një vështrim më tej në rezultatet

tona ofron njohuri të dobishme në rrethanat në të cilat FDI mund të ndihmojnë ose pengojnë zgjerimin horizontale e eksporteve.

**N. Prasanna (2010)** në një botë të globalizuar, sukcesi I eksportit mund të shërbejë si një masë për konkurrencën e një vendi industrial dhe të çojë në rritje të shpejtë. Kohët e fundit, një pamje shumë optimiste në rolin e Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në performancën e eksportit në vendin pritës ka evoluar. Qeveria e Indisë lëvizur në këtë drejtim në mesin e 1991 e cila ka rritur fluksin e IHD-ve në Indi. Ky studim eksploron ndikimin e IHD-ve në performancë e eksportit të Indisë, gjithashtu ky studim konstaton se ndikimi I IHD-ve në performancën e hyrjeve të eksporteve është pozitive.

**Salami, A. O. & Oyewale, I. O.** Duke pasur parasysh bazen ekonomike te Nigerise, politika e investimeve te huaja duhet te levize drejt terheqjes se sa me shume investimeve te huaja te kapitalit. Nevoja per investimet e huaja direkte ka lindur nga natyra zhvillimore e ekonomise se vendit e cila esencialisht e ka penguar ritmin e zhvillimit te saj ekonomik. Keshtu, ky studim hulumton lidhjen midis hyrjeve nderkombetare tregtare dhe punesimit ne Nigeri per periudhen kohore 1990-2010. Duke perdorur tekniken e vleresimit te serive kohore, ne gjetem nje lidhje te fuqishme midis Investimeve te huaja direkte dhe punesimit, si ne periudhen afatshkurte ashtu edhe ate afatgjate. Sidoqofte, faktoret e jashtem sic jane: kursi real i kembimit, importi dhe faktoret e brendshem si inflacioni dhe eksporti kane nje rol me te rendesishem ne spjegimin e punesimit ne Nigeri. Prandaj, Investimet e huaja direkte duhet te fokusohen me shume ne sektorin e bujqesise per shkak te strategjise relevante qe ka ky sektor ne ekonomine kombetare, vecanerisht ne punesimin e gjeneratave. Perpjekjet e qeverise duhet te orinetohen ne thithjen e ketyre investimeve per te inkurajuar ritjen e produktivitetit dhe te gjeneroje punesime te reja per popullsine rurale.

**Goran Vukšić MSc (2005)** Eksportet e industrisë prodhuese te Kroacise kane stagnuar pergjate dekaodes se fundit por edhe me shume. Pergjate periudhes se njejte kohore, relativisht ka pasur hyrje te medha te investimeve te huaja direkte ne industri. Qellimi i ketij punimi eshte te hulumtoje, pas kontrollimit te variablave tjera te rendesishme, ne qofte se keto hyrje kane pasur ndonje ndikim ne performancen e eksportit. Duke perdoren metoden e Panel Data per 21 industri prodhuese per periudhen kohore 1996-2002, eshte gjetur se Investimet e huaja direkte kane ndikim pozitiv dhe ne menyre signifikante kane ndikuar ne eksporte, por shtrirja e ketij efekti ka qene relativisht e vogel. Nga ana tjeter, kjo tregon se ka potencial per permirsimit te performances se eksportit te industrise prodhuese kroate duke terhequr sa me shume investime te huaja ne kete sektor. Politikberesit duhet te risin potencialin e efekteve pozitive te investimeve te huaja direkte duke targetuar me teper Investimet e huaja direkte te Greenfield me orientim eksportin, dhe, mes tjerash, te implementoje masa per te perhapur efektet pozitive te ketyre investimeve.

**Oyatoye, E. O., Arogundade, K. K, Adebisi, S. O & Oluwakayode, E. F.(2011)** Ky studim shqyrton ndikimin e mundshëm dhe marrëdhëniet në mes të Investimeve të Huaja Direkte, dhe Rritjes Ekonomike në Nigeri. Të dhënat për këtë studim janë me burim nga llogaritë vjetore dhe Buletini statistikor i Bankës Qendrore të Nigerisë (CBN). Shtrirja mbulojnë një periudhë prej 20 vjet (1987 - 2006) dy vjet përfshirëse. Analiza e regresionit të zakonshëm metoda katrore ((OLS) është përdorur në analizimin e të dhënave. Ky studim ka arritur në përfundim se egziston një lidhje pozitive në mes investimeve të huaja direkte dhe produkti I brendshëm bruto (GDP).

**Piya Wongpit** rezultatet tregojnë se IHD ka një ndikim pozitiv në eksportin e prodhimit nga Tailanda në vendet tjera.

**Basem Mohammed Louzi & Abeer Abadi** investimet e huaja direkte (FDI) supozohet të përfituar një vend të varfër si Jordani. Jordania ofron mundësitë e investimeve tërheqëse për kompanitë e huaja dhe ka miratuar një numër të politikave për të tërhequr investimet e huaja direkte në vend. Ky artikull përqendrohet në hipoteza e rritjes së IHD-ve të udhëhequr në rastin e Jordanit. Studimi është bazuar në të dhënat seri kohore nga viti 1990 deri në vitin 2009. Në rezultatet ekonometrike tregojnë se flukset e IHD nuk ushtrojnë një ndikim të pavarur në rritjen ekonomike. Dhe ndikimi i DIN dhe TP në PBB norma e rritjes është gjetur të jetë pozitiv. Bazuar në këto rezultate objektivi përfundimtar i qeverisë Jordan është që të tërheq IHD për zhvillimin e një politike mixe të përshtatshme që është e nevojshme që duhet të ndërmerren në të ardhmen.

## II.1 Investimet e huaja direkte në Maqedoni dhe vendet tjera

Republika e Maqedonisë njihet si vendi më atraktiv për kompanitë e jashtme dhe investitorë të ndryshëm, që një pjesë të kapitalit të tyre t'a investojnë brenda kufijve të këtij shteti. Në raportet e ndryshme të komisioneve evropiane, Maqedonia është ranguar në një nga vendet e para në krijimin e infrastrukturës më të mirë ligjore për regjistrimin e kompanive të huaja në vend, lirimet e shumta tatimore (me e njohura është 0% tatim për fitimet e investuara në kompani dhe në vend), fuqi e lirë punëtore dhe lloj-llojshmëri të kuadrove profesionale, lokacion strategjik në Gadishullin Ballkanik qasje të lehtë tregtare në vende si: Greqia (anëtare e Unionit Evropian), Serbia, Shqipëria, Kosova, Turqia, Mali i Zi, Kroacia etj.

Në raportin më të fundit të Bankës Botërore, në studimin e së cilës Banka Botërore ka analizuar kushtet optimale të vendeve të ndryshme të botës për realizimin e aktiviteteve biznesore, Maqedonia rradhitet në vendin e 11-të, menjëherë pas vendeve si: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Anlgia, Danimarkës, Singapurit, Zelandës së Re dhe është ranguar më lartë se vendet: Australia, Finlanda, Spanja, Portugalia dhe shumë vendeve tjera të cilat kanë zhvillim më të lartë ekonomik në krahasim me Maqedoninë (për më shumë informacione, shihni ju lutem tabelën 1.1 – Raporti i Bankës Botërore për rangimin e vendeve më të mira për të realizuar bizneset e tyre).

### **Avantazhet konkurruese të Republikës së Maqedonisë për IHD-të**

Shume analistë dhe investitore do të pyesnin veten se pse ata do duhet të investonin në Maqedoni? Ne pikat e mëposhtme do të paraqesim disa nga arsyet të cilat janë:

1. Lokacioni i përshtatshëm gjeografik
2. Infrastrukturë të shkëlqyeshme investive
3. Fuqi punëtore kompetitive
4. Mundësi perfekte të organizimit të logjistikës dhe transportit (transportimi i mallrave brenda 3 ditëve nëpër gjithë Europën nëpërmjet rrugëve tokësore dhe hekurudhore)
5. Ka 2 aeroporte internacionale me një numër të madh të fluturimeve brenda ditës
6. Qasje tek portet detare internacionale
7. Është afër Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore

Në rreshtat në vijim nëpërmjet paraqitjes grafike do të prezentojmë pikat e lartëpërmendura.



## Location and Transport Infrastructure



Foto 1.0: Pershkrimi i avantazheve konkurruese te RM-së.

## Continuous implementation of reforms

### Regulatory reforms

- ✓ One-Stop-Shop: 4 hours company registration
- ✓ Regulatory Guillotine
- ✓ Electronic One-Stop-Shop for customs permits and licenses
- ✓ Single window: Improving interoperability between government institutions

### Cadaster reforms

- ✓ Digital Cadaster covering 99% of the real estate in Macedonia
- ✓ Notaries and land surveyors have access to land register through on-line system

### Liberalization of real-estate market

- ✓ Foreigners free to purchase real estate and construction land
- ✓ Simplification of procedures for obtaining construction permits from 21 to 3 steps

### Liberalization of Labor Market

- ✓ Modern Labor Law
- ✓ Improved labor force flexibility

Foto 2.0: Lehtësirat ligjore për tërheqjen e investimeve.

Duke u nisur nga këto informata primare, le të nënkuptojë që Maqedonia me të vërtetë është një “parajsë” e dëshiruar për shumë kompani të cilat janë të interesuara të krijojnë produkte cilësore dhe me kosto shumë të ulëta. Por a thua vallë këto procedura legjislative kanë dhënë efektin e dëshiruar? Sa ka qenë fluksi i investimeve të huaja direkte në Maqedoni në dhjetë vjeçarën e fundit dhe s’ka pasur efekt kjo në rritjen ekonomike dhe të eksportit të Maqedonisë?

Në tabelën e mëposhme do të paraqesim të dhënat e GDP-së, investimeve të huaja direkte dhe eksportin në Maqedoni gjatë viteve 2000-2015 për të parë trendin (rritjet-ngritjet) e variablave të lartpërmendura:

**Tabela 1.2 Të dhënat e eksportit në Republikën e Maqedonisë.<sup>10</sup>**

Vitet	Eksporti ('000 USD)	Vitet	Eksporti ('000 USD)
2000	\$ 1,322,617	2010	\$ 3,351,429
2001	\$ 1,157,507	2011	\$ 4,478,313
2002	\$ 1,115,527	2012	\$ 4,015,417
2003	\$ 1,366,989	2013	\$ 4,298,772
2004	\$ 1,675,877	2014	\$ 4,964,132
2005	\$ 2,042,296	2015	\$ 4,530,077
2008	\$ 3,990,642	2016	\$ 4,854,746
2009	\$ 2,708,488	2017	\$ 5,671,466

### Paraqitja Grafike



<sup>10</sup> Të dhënat nga tabela e mësipërme janë marrë nga Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë: [http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat\\_\\_NadvoresnaTrgovija\\_\\_Indikator/125\\_pokrienost\\_ml.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef](http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat__NadvoresnaTrgovija__Indikator/125_pokrienost_ml.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef)

## II.2 Politikat promotive për tërheqjen e investimeve të huaja direkte

Qeveria e Republikës së Maqedonisë bën përpjekje të vazhdueshme për përpilimin e politikave më atraktive me qëllim “joshjen” e investitorëve të nryshëm me ç’rast, do të ndikonte në hapjen e kapaciteteve prodhuese në vend, fluks intern të mjeteve të ndryshme devizore, kapitalit, eksperiencës dhe produkteve të ndryshme në treg.

Në vazhdën e këtij punimi do të shtjellojmë politikat qeveritare dhe kushtet minimale që duhet të plotësohen që një investim i huaj të jetë i denjë dhe i suksesshëm.

- 1) Kompanitë duhet të paraqesin rritje të të ardhurave të vitit të fundit në krahasim me mesataren e 3 viteve të kaluara
- 2) Kompanitë duhet të paraqesin rritje të numrit të të punësuarve të vitit të fundit në krahasim me mesataren e 3 viteve të kaluara

Nga pikat e mësipërme, ne kuptojmë që ndërmarrjet e huaja të cilat janë të interesuara të investojnë në tregun tonë, duhet të demonstrojnë fuqi të mjaftueshme ekonomike dhe potencial rritës me qëllim që të arrijnë të bindin organet vendimmarëse në qeveri dhe tregun se ato ofrojnë me të vërtetë produkte cilësore dhe do të ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e tregut vendas dhe rritjen e konsumit të produkteve.

Për të përforcuar edhe më tej promovimin e infrastrukturës investive të Republikës së Maqedonisë, qeveritë e ndryshme i mbështesin politikat e tyre në tre shtylla kryesore:

- 1) **Shtylla e parë:** masa ekonomike për mbështetje të ndërmarrjeve që kanë rritje të vazhdueshme ekonomike në treg
  - a. Mbështetje financiare duke krijuar vende të reja të punës për qytetarët e Republikës së Maqedonisë
  - b. Mbështetje financiare për krijimin e lidhjeve të bashkëpunimit me kompani dhe furnitorë të ndryshëm që veçmë operojnë në tregun e Republikës së Maqedonisë
  - c. Mbështetje financiare për krijimin e departamenteve, qendrave dhe formave tjera të strukturave të organizimit të cilat do të përdoren për hulumtime dhe zhvillim të projekteve të ndryshme dhe do të angazhojnë staf me kualifikime të larta profesionale
  - d. Mbështetje të projekteve investuese të cilat kanë një interes të lartë ekonomik
  - e. Mbështetje financiare për kompanitë që realizojnë investime fillestare ose investime shtesë në tregjet ku operojnë
  - f. Mbështetje financiare për kompanitë të cilët e fillojnë investimin e tyre me blerjen e aseteve të kompanive që kanë bankrotuar apo janë në procedurë falimentimi.
- 2) **Shtylla e dytë:** masa për mbështetje të konkurrencës – inkurajimin e sipërmarrësve të rinj për të hapur sa më shumë biznese të natyrës së njëjtë me çrast stimulohet rritja e konkurrencës dhe cilësisë së produkteve dhe shërbimeve në treg

- a. Mbështetje financiare për kompanitë që e rrisin konkurrencën në tregun vendor me produktet dhe shërbimet e tyre (mjetet që jepen për këtë qëllim janë të pa revokueshme që do të thotë se kompania nuk ka nevojë t'i kthen këto mjete)
  - b. Mbështetje të kompanive të cilat synojnë tregje të reja dhe tentojnë të zgjerojnë shitjet e tyre.
- 3) **Shtylla e tretë:** masa për mbështetje të subjekteve të mesme ekonomike (SMEs)
- a. Mbështetje të subjekteve të mesme ekonomike të cilat kanë trend të shpejtë të rritjes ekonomike
  - b. Mbështetje të subjekteve të cilat merren me inovacione dhe përmirësime të vazhdueshme të produkteve dhe shërbimeve
  - c. Mbështetje për integrimin e punonjësve të rinj në sektoret e ndryshme të veprimtarisë ekonomike
  - d. Krijimin e kushteve ligjore për krijimin dhe zhvillimin e kapitalit të përbashkët (Venture Capital) me qëllim investimin e atyre mjeteve në industry të ndryshme.

### II.3 Zonat e lira ekonomike në Republikën e Maqedonisë

Para se të fillojmë me shpjegimin e zonave të lira ekonomike në vendin tonë, së pari do doja të jepja definimin e zonës së lire ekonomike. Në literatura të ndryshme një zonë e lirë ekonomike definohet si një zonë në të cilën ligjet e biznesit dhe të tregtisë janë të ndryshëm nga pjesa tjetër e vendit. Ato janë të vendosura brenda kufijve kombëtarë të një vendi, dhe qëllimet e tyre përfshijnë rritjen e bilancit tregtar, punësimin, rritjen e investimeve, krijimin e vendeve të punës dhe administrimin efektiv. Për të inkurajuar bizneset të vendosen në zonë, politikat financiare vijnë në shprehje. Këto politika zakonisht përfshijnë investime, tatime, tregti, kuota, dogana dhe rregullore të punës. Për më tepër, kompanive mund t'u ofrohen pushime tatimore, ku pasi të vendosen në një zonë, atyre u jepet një periudhë tatimi më të ulët.

Në Republikën e Maqedonisë në programin qeverisës 3 vjeçar janë paraparë gjithsej 15 Zona të lira ekonomike në mbarë vendin edhe ate:

- 3 zona të lira ekonomike - Shkupi 1, Shkupi 2 dhe Shtip – këto zona janë operative dhe ka shumë kompani të ndryshme të huaja të cilat kanë investuar
- 1 zonë e lirë ekonomike në Tetovë – vlen të përmendim se kjo zonë është në partneritet publiko – privat dhe se është në procedurë ligjore për shtetëzimin e kësaj hapësire me qëllim zgjidhjen e problemeve të mundshme që mund t'i hasin kompanitë e huaja në ballafaqim me pronarët e tokës e cila është pjesë e zonës ekonomike
- 11 zona tjera ekonomike të cilat pritet të shtrihen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë si psh: Kërçov, Strugë, Gjevgjeli, Prilep, Rankovcë, Delçevë etj.

Në vazhdim të këtij punimi, do të gjeni një paraqitje grafike të zonave të lira të cilat shtrihen në tërë territorin e republikës sonë.

## Technological Industrial Development Zones



Foto 3.0: Shtrirja gjeografike e Zonave të lira në Republikën e Maqedonisë

### Benefitet fiskale që ofrojnë zonat e lira ekonomike

Zonat e lira ekonomike ofrojnë benefite ose përparësi të shumta kompanive të huaja që planifikojnë të investojnë në Republikën e Maqedonisë. Në tabelën e mëposhtme do t'iu paraqesim përparësitë që fitojnë kompanitë e huaja në rast të investimit në këto zona:

Tatimet	Normat Tatimore	
	Brenda zonave ekonomike	Jashtë zonave ekonomike
Tatimi në fitim	0% - në 10 vitet e para	10%
Tatimi në të ardhurat personale	0% - në 10 vitet e para	10
TVSH	0%	18%
Tatimi I pronës	0%	0.1%-0.2%
Akcizat	0%	5%-62%


Produktet	Tarifat doganore	
	Brenda zonave ekonomike	Jashtë zonave ekonomike
Lënda e parë e materialeve	0%	deri në 15%
Pajisjet e ndryshme, Maqineritë	0%	5%-20%

Përveç benefiteve të lartpërmendura, shteti në zonat e lira ekonomike ofron edhe këto shërbime:

- Kyçje në rrjetin e energjisë elektrike të qytetit ku gjenden këto zona
- Kyçje në rrjetin e telekomunikacioneve dhe internetit
- Ndriçim public
- Kyçje në sistemet monitoruese të sigurimit
- Kyçje në sistemet e kanalizimit dhe ujërave të zeza
- Kyçje në sistemin e gazit (vetë më Shkup, përkatësisht në Zonën 1 dhe 2)
- Subvencionim deri më 500,000 Euro të projekteve të ndërtimtarisë
- “Green Customs Channel” – që nënkupton lehtësira të shumta tatimore për produktet që kane destinacion tregun Evropian dhe transportim të shpejtë të produkteve nga Zona e Lirë Ekonomike drejt vendeve evropiane.
- Toka në Zonat Ekonomike jepet me qira për një periudhë shumë të gjatë kohore (99 vjet)
- Grante të ndryshme për trajnimin e punëtorëve
- E gjithë struktura legislative dhe ekonomike e veprimtarisë së ndërmarrjeve është në të njëjtën linjë me ligjet dhe rregullativat evropiane.

Në vazhdim, në mënyrë grafike do të paraqesim edhe kompanitë e huaja të cilët kanë investuar në këto zona ekonomike:

## Major recent investors in Greenfield sites



## Major recent investors in Greenfield sites



Për të vërtetuar suksesin e këtyre investimeve në vendin tonë, në tabelën e mëposhtme do të paraqesim disa të dhëna të shprehura në përqindje të eksporteve të cilat janë realizuar vetëm nga zonat e lira ekonomike në proporcion me eksportet total në nivel republikan.

Viti	% e totalit të eksporteve
2012	20%
2013	25%
2014	31%
2015	36%
2016	40%
2017	Mbi 40%

Nga tabela nënkuptojmë që eksportet nga zonat e lira ekonomike në vitin 2016 kapin shifrën e 1,7 Miliardë Euro ose 40% e vlerës së përgjithshme të eksporteve ndërsa në vitin 2017 kjo shifër arrin mbi 2 Miliardë Euro ose mbi 40% të vlerës së përgjithshme të eksporteve. Nga kjo le të nënkuptojmë që këto zona ekonomike, me të vërtetë e kanë arritur efektin e tyre në disa pika, edhe atë:

- Përmirësimin e balancit tregtar
- Rritjen e nivelit të teknologjisë në vend
- Rritje të cilësisë së fuqisë punëtorëve dhe zvogëlimin e papunësisë
- Përmirësimin e qasjes në capital
- Rritjen e bashkëpunimit midis kompanive vendore dhe atyre të huaja, nxitjen e konkurrencës vendase dhe përmirësimin e cilësisë së produkteve



### III.1 Metodologjia e punimit dhe të dhënat

Për të vërtetuar hipotezat tona që i përmendem më lartë, ne do të përdorim disa metoda të ndryshme analitike për të studiuar me thellë të dhënat të cilat i kemi grumbulluar gjatë hulumtimit për këtë çështje. Nga rishikimi i literaturave tjera, shumë autore kanë përdorur metoda të ndryshme edhe atë: *Metoda Panel Data*, e cila është një teknikë statistikore që përdor tre qasje: qasja fikse, qasja e rastësishme dhe qasja Husmman–Taylor. Këtë metodologji do ta përdorim për të konstatuar ndikimin e determinantave si Investimet e huaja direkte, eksportin, rritjen ekonomike dhe ndryshimet e kursit të këmbimit valutor për Republikën e Maqedonisë dhe vendeve në tranzicion.

Për grumbullimin e të dhënave për variablat e sipërpërmendura, kemi shfrytëzuar burime të ndryshme statistikore edhe atë:

- Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë
- Banka Botërore
- Fondi Monetar Ndërkombëtar
- Banka Qendrore e Republikës së Maqedonisë
- Ministria pa resor për investime të huaja direkte

Para se të futemi në analizën e të dhënave të cilat i gjeneruam nga burimet e lartpërmendura, si fillim, do të themi ca fjalë për modelet ekonometrike të cilat do t'i përdorim në këtë punim, specifikat e tyre, teknikat dhe rezultatet e mundshme që japin këto modele. Për shpjegimin e këtyre modeleve, janë përdorur literatura të ndryshme ekonomike, libra nga ekonomistë të ndryshëm të cilët kanë shpjeguar funksionimin e këtyre modeleve dhe rezultatet që nxjerrin nga analiza e detajuar ekonometrike e variablave. Literaturat e përdorura do t'i paraqesim si referenca në fund të punimit. Pasi të shpjegohen këto fenomene, do ti analizojmë dhe testojmë të gjitha të dhënat në hulumtimin shkencor, si dhe do të bëjë përllogaritjen e modeleve ekonometrike dhe interpretimin e rezultateve.

**Panel Data** është një metodë statistikore, e përdorur gjerësisht në shkencat shoqërore, sidomos në ekonometri, që merret me observimin e të dhënave gjatë dy dimensioneve edhe atë: “Cross Sectional dhe Times Series”<sup>11</sup>. Të dhënat zakonisht grumbullohen me kalimin e kohës dhe mbi të njëjtit individë (ku në rastin tone konkret shtetet), më pas drejtohet një regresion mbi këto dy dimensioneve. Analiza multidimensionale është një metodë ekonometrike në të cilën të dhënat grumbullohen në më shumë dimensioneve, edhe atë (tipike, kohore ,individuale dhe në disa raste të dimensioneve të treta). Panel data, mundëson që të kontrollohen disa lloje të variablave të cilat nuk janë të inkuadruara në model , duke mos i futur ato në observim, duke observuar ndryshimet në variablat e varur përgjatë kohës. Gjithashtu kontrollon edhe variablat e panjohura që dallojnë

---

<sup>11</sup> Cross-sectional Dependence in Panel Data Analysis, Vasilis Sarafidis and Tom Wansbeek,2010

në mes rasteve por që janë konstante përgjatë kohës, si dhe rastet kur variablat e panjohura janë të ndryshme përgjat kohës, ndërsa konstante në mes rasteve.

### 1.1 Specifikimi I modelit te thjesht linear

Nëpërmjet metodës së regresionit të thjeshtë linear<sup>12</sup> dhe nëpërmjet aplikimit të metodës së katrorëve të vegjël (OLS), ne do të testojmë efektet e investimeve te huaja direkte (dhe variablate tjera relevante si: rritjes ekonomike, indeksin e korupsionit, lirin ekonomike) eksportin e Republikës së Maqedonisë dhe vendeve të tranzicionit.

Përlllogaritjet do ti realizojm nëpërmjet modelit të regresionit linear tredeminzional si vijon:

$$Y = B_1 + B_2X_1 + B_3X_2 + B_4X_3 + B_5X_4 + B_6X_5 + u_i$$

**Y**- paraqet variablen e nvarur ne rastin tone te hulumtimit si variabel e n'varur është per capita rritja ekonomike.

**X** - paraqet variablën e pavarur në rastin tonë të hulumtimit si variabla e pavarur është :

B1, B2, B3, B4, B5 dhe B6 thiren prametra ose koeficientët e vlersimit; ku B1 është parametri i konstantës, kurse B2, B3 B4 B5 dhe B6 janë parametrat e vlersimit të variablës së n'varur .

**ui** - është variabel stokastike ose error term, përmban të gjitha faktorët ose variablat që nuk janë paraparë në model dhe është variabël random e pa obzervuar mer vlera pozitive dhe negative.

### 1.2 Vleresimi i metodes ols<sup>13</sup>

Ekuacioni i regresionit është ekuacion që definon raportet në mes të dy variablave dhe shfrytëzohet për të vlerësuar variablen e varur (Y) të bazuar në variablen e pavarur (X). Variabla e varur (Y) është variabla e projektuar apo e vlerësuar që kërkohet të parashikohet ose të shpjegohet me anën e një variable tjetër. Variabla e pavarur (X) është variabla që siguron bazën për vlerësim. Me anë të kësaj variable bëhet parashikimi ose shpjegimi i variablit te varur.

Thjeshtësia e këtij modeli rrjedh nga supozimi për termin error: që supozohet së  $e \approx N(0, \sigma^2)$ . Me fjalë të tjera, duke e ditur vlerën e termit error i cili në model nuk sqaron asgjë në lidhje me

<sup>12</sup> Basics of econometrics, Fourth Edition, Damodar N. Gujarati

<sup>13</sup> Analiza e kursit devizor në Republikën e Maqedonisë, Besnik Fetaj, Tetovë 2014, fq 8

variablat tjera (distribuími i termit error është i pavarur nga variablat tjerë), si dhe observimet e termit error janë të pa korreluara me njëra tjetrën. Pas shqetësimeve të përmendura nga modeli klasik i regresionit linear, vlerësimi efikas mund të arrihet duke përdorur metodën e katrorëve të vegjël (OLS). Edhe përkundër paragjykimëve të shumta, ngjashëm si në studimet e tjera edhe në këtë studim të dhënat e grumbulluara do të vlerësohen me anë e katrorëve të vegjël (OLS), dhe disa metoda tjera të regresionit si Fixed Effect dhe Random Effect në analizën e tonë empirike të këtij hulumtimi të temës së masterit.

### 1.3 Modelet fixed dhe random effects<sup>14</sup>

Duke marrë në konsideratë modelin e mëposhtëm:

$$Y_U = X_U + E_U$$

Gjithashtu, duke marrë në konsideratë se "Error Term" ka strukturën e mëposhtme:

$$E_U = a_i + n_{it}$$

Termi i parë i dekompozimit njihet si një efekt specifik-individual, dhe pjesa e dytë korrespondon me termin e zakonshëm i njohur si "Common Stochastic Error Term", për shembull, modelet klasike me regresion linear. Në këtë formulim, pjesa e parë ndryshon përgjatë individëve ose njësisive, pra në rastin tonë shteteve, por është konstant përgjatë kohës, kjo pjesë mund ose nuk mund të jetë në korrelacion me variablat sqaruese.

Pjesa e dytë varion në mënyrë arbitrare përgjatë kohës dhe vendeve. Ky formulim është mënyra më e thjeshtë e të kuptuarit të idesë se dy observacioneve nga i njëjti vend do të jetë më shumë si njëri tjetri, sesa observacionet nga dy vende të ndryshme. Dallimi thelbësor ndërmjet Fixed Effects dhe Random Effects qëndron nëse efekti i pavrojtuar individual numëron elemente që janë të lidhura (korrelacion) me regresorët në model, jo nëse këto efekte janë rastësorë (stochastic) ose jo, (Green, 2008,p.183), në rastin tonë mund ose nuk mund të jetë në korrelacion me grupin e variablave shpjeguese. Modeli Fixed Effects nuk është në korrelacion me modelin Random Effects . Nga rrjedh që në modelin Fixed Effects, supozohet të jenë "n" parametra të panjohura që duhen vlerësuar, ndërsa në rastin e modelit Random Effects trajtohen si vizatime nga një shpërndarje me mesatare "μ" dhe variancë të cilat janë të pavarura nga variablat shpjegues në. Siç do të trajtohet më vonë në këtë hulumtim shkencor, se vlerësuesi Hausman-Taylor IV ofron alternativë për sa i përket qasjes "të gjitha ose asgjë"

#### 1.3.1 Modeli Fixed Effects

Përdorimi i efekteve fikse bëhet sa herë që jemi të interesuar të bëjmë analizimin e ndikimit të variablave që ndryshojnë me kalimin e kohës. Efektet fikse trajtojnë marrëdhëniet në mes parashikuesve dhe rezultateve të variablave brenda një njësie ekonomike (vendi, personi, kompani, etj). Çdo njësi ka karakteristikat e veta të veçanta që mund ose nuk mund të ndikojnë variablat

<sup>14</sup> Introduction to Regression and Analysis of Variance, Fixed vs. Random Effects, Jonathan Taylor

parashikuese (për shembull, duke qenë një mashkull apo femër mund të ndikojë opinionin drejt një çështje të caktuar, ose sistemi politik i një vendi të caktuar mund të ketë ndonjë efekt në tregti ose GDP, ose praktikat e biznesit të një kompanie mund të ndikojnë në çmimin e aksioneve). Në ekonometri dhe statistik, modeli “Fixed Effects” është një model statistikor që përfaqëson sasi të vrojtuar në drejtim të variablave shpjeguese që trajtohen sikur sasi të ishin jo të rastit. Për dallim nga modelet “Random Effects, si dhe “Mixed Effects”, në të cilat, të gjithë ose disa nga variablat shpjeguese trajtohen sikur të rrjedhin si rrjedhojë e rastit. Po të krahasojmë këtë me përcaktimet biostatistike, ku biostatisticientët përdorin efektet "fixed" dhe "random" për t'iu referuar popullsisë mesatare dhe efekteve të subjekteve specifike (aty ku këto të fundit në përgjithësi janë të supozuara të jenë të panjohura, apo variabla latente).

Në të shumtën e rasteve, struktura e njëjtë e modelit që zakonisht është një model regresioni linear, mund të trajtohet nga njëra prej tre llojeve, në varësi nga pikëpamjet e hulumtuesit, megjithëse mund të jetë një zgjedhje e natyrshme në ndonjë situatë të dhënë. Po ashtu vlen të theksohet se vlerësimet konsistente të parametrave shtesë nuk mund të merren për bazë. Edhe pse nuk mund të llogarisim në vazhdimësi, megjithatë llogarisim parametrat e mbetura në vazhdimësi. Për tu bërë kjo, regresioni merr këtë formë  $y = X\beta + \epsilon$  ku “F” paraqet matricën që bën grumbullimin e “n” variablave, d.m.th. ato variabla të cilat janë korenspoduese për çdo vend. Avantazhi i modelit “Fixed Effects” është largimi apo heqja e heterogjenitetit specifik individual (Individual-Specific Heterogeneity), që mund të shfaqet nga qasja “Deviations from Means”, duke marrë në konsideratë ekuacionet si në vijim:

$$\bar{y} = \bar{X}\beta + B + a_i + n_i$$

$$y_u - y_i = (X_u - X_i)\beta + (n_u - n_i)$$

Përderisa heterogjeniteti i pavëzhgueshëm është kontabilizuar, ka një pengesë bazike për atë kohë që vlerësuesi përdor vetëm variacione përbrenda observacioneve individuale. Kjo mund të jetë problematike në qoftë se ekzistojnë shpjegime të ashtuquajtura "Time In Variant". Kur përdorni efektet fikse supozojmë se diçka brenda individit mund të ndikojnë ose mund të kemi paragjykim në rezultatin e variablave të cilat kemi nevojë për ti kontrolluar.

Kjo është arsyeja pas supozimit se korrelacioni midis variablave tek njësia ekonomike mund të parashikohet gabimisht. Një tjetër supozim i rëndësishëm i modelit të efektit fiks është se karakteristikat në kohë të pandryshuar janë unike për individin dhe nuk duhet të lidhen me karakteristikat e tjera individuale. Çdo subjekt është i ndryshëm, pra termi gabim i njësisë ekonomike është konstante (e cila kap karakteristikat individuale) që nuk duhet të lidhen me të tjerët. Nëse kushtet e gabimit janë të lidhura, atëherë efektet fikse nuk janë të përshtatshme dhe ndikojnë që konkluzionet të cilat fitohen nga rezultatet e modelit të mos jetë të sakta, dhe si pasojë e këtij procesi kemi nevojë për të modeluar këtë marrëdhënie , kjo është arsyeja kryesore që mund të shpie deri tek përdorimi i testit Hausman që do të trajtojë më poshtë gjatë këtij hulumtimi shkencor.

Ekuacioni për modelin e efekteve fikse bëhet:

ku kemi:

$$Y_{it} = \beta_1 X_{it} + a_i + u_{it}$$

$a_i$  ( $i = 1 \dots n$ ) është ndërpris i panjohur për secilin entitet,

$Y_i$  - është variabla e varur (DV),

$i$  - entitet,

$t$  - koha,

$X_i$  - përfaqëson një variabël të pavarur (iv),

$\beta_1$  - është koeficienti ,

$u_i$  - është termi gabim,

Pasqyra kryesore është se në qoftë se variabla e pashënuar nuk ndryshon me kalimin e kohës, atëherë si rezultat çdo ndryshim në variablen e varur duhet të jetë për shkak të ndikimeve të ndryshme nga këto karakteristika fikse (Stock dhe Eatson, 2003, p.289-290).

Në rastin e të dhënave të serive kohore interpretimi i koeficienteve beta do të jetë për një vend të caktuar, kur  $X$  ndryshon në kohë nga një njësi, ndërsa rritet  $Y$  ose zvogëlohet njëra nga njësitë  $\beta$  (Bartels, Brandom, Stony Brook University, 2008 ). Një tjetër mënyrë për të parë modelin efektet fikse është duke përdorur ndryshoret binare. Pra ekuacioni për modelin efektet fikse bëhet:

$$Y_{it} = \beta_0 + \beta_1 X_{1,it} + \dots + \beta_k X_{k,it} + \gamma_2 E_2 + \dots + \gamma_n E_n + u_{it}$$

ku kemi:

$Y_{it}$  - është variabël e varur , ku  $i$  = entitet dhe  $t$  = koha,

$X_k$  -paraqet variablen pavarur ,

$\beta_k$  është koeficienti ,

$u_{it}$  është gabimi,

$e_n$  - ato subjekte që janë në numra binarë (dummies), kemi  $n-1$  subjekte të përfshira në model,

$\gamma_2$  është koeficienti binar (subjektet në model).

Të dy ekuacionet të cilat i trajtuam me lartë janë ekuivalente njëra me tjetrën.  $X$  është i njëjtë nga njëri entitet në tjetrin, po ashtu edhe tek ekuacioni me lartë të dhënat kanë të njëjtin burim duke paraqitur një variable të pashënuar që ndryshon tek të gjitha shtetet që janë në model, por jo gjatë gjithë kohës së vrojtimit(Stock dhe Eatson, 2003, p.280). Ju mund të shtoni efekte kohore tek njësia ekonomike përmes modelit të efekteve, ku duhet të ketë një kohë dhe njësi fikse.

### 1.3.2 Modeli Random Effects

$$y = Xit\beta + \varepsilon it$$

ku

$$\varepsilon it = ait + nit$$

Arsyeja e përdorimit të modelit me efekte të rastit është se ndryshon nga modeli i efekteve fikse, variacioni i të gjitha subjekteve supozohet të jetë i rastësishëm, dhe është i pa lidhur me parashikuesit dhe variablat tjera të pavarura të përfshira në modelin ekonometrik (Green 2008, p.183). Nëse kemi një variabël të varur në model, atëherë ju duhet të përdorni modelin e efektit të rastit. Në statistikë modeli “Random Effects”, gjithashtu i njohur si modeli i komponentëve të ndryshimit, është një lloj modeli hierarkik linearë. Ky model supozon se të dhënat po analizohen në koordinim nga një hierarki të popullsisive të ndryshme, dallimet e të cilëve lidhen me atë hierarki. Në ekonometri, modelet “Random Effects” janë përdorur në analizën e të dhënave hierarkike apo panel, në rastet kur nuk ka efekte fikse, domethënë nuk ka efekte individuale. Modeli “Random Effects” është një rast i veçantë i modelit “Fixed Effects”. Një avantazh i efekteve të rastit është që ju mund të përfshini në kohë variablat e pandryshueshme (p.sh. gjinore), ndërsa në modelin e efekteve fikse këto variabla janë të absorbuara nga modeli.

Në këtë rast supozimi kryesor që dallon këtë model nga modeli “Fixed Effects” është se pandryshueshmëria e kohës së efekteve specifike të vendeve (shteteve) .

Po ashtu, vlen të theksohet se është i dobishëm që të jetë më eksplicitë në lidhje me dy pjesët e “Termit Error”.

$$E[\eta it X] = E[ait X] = 0,$$

$$E\eta it X = \sigma\eta,$$

$$Eai X = \sigma a,$$

$$E[aX] = 0, \eta$$

$$E[ai a j X] = 0, \text{ për } 'I' \neq 'j'.$$

Modeli “Random Effects” në një far mënyrë është për tu marrë me faktin se “t” observacionet në “n” vende nuk janë të njëjta si observacionet në “nt” të vendeve të ndryshme. Më pas modeli llogaritet si vijon se pari duke nxjerr një vlerësues të matricës së kovariancës të termit error, dhe së dyti duke përdorur këtë strukturë të kovariancës në vlerësuesin e “β”. Nëse komponentët e variancës janë të njohura, atëherë vlerësuesi “GLS”, gjegjësisht “Random Effects” mund të zbatohet pa vështirësi. Megjithatë zakonisht nuk ndodh kështu, pasi që vlerësimet e variancës së panjohur janë të nevojshme. Vlerësuesit konsistent mund të nxirën si shuma të modifikuara në mënyrë të përshtatshme së gabimeve të formave katrore nga dy vlerësues të ndryshëm, të njohur si “Ndërmjet Vlerësues” dhe “Brenda Vlerësues”. Duke përmbledhur dy vlerësuesit e fundit të prezantuar, pra “Fixed Effects” dhe “Random Effects”, që të dy janë modele të dizajnuara për të

trajtuar strukturë të veçantë të të dhënave gjatësore ose panel, ku heterogjeniteti i pavëzhgueshëm individual është marrë parasysh nga të dy modelet. Dallimi ndërmjet modeleve në fjalë, është nëse efektet specifike individuale që variojnë përgjatë kohës janë në korrelacion me represorët ose nuk janë.

Siç vëmë në dukje më parë, variablat "Time-Invariant" nuk mund të përdoren. Për më shumë gabimi në matje në "X" si dhe ndryshimet endogjene në "X" mund të shpijnë në rezultate të njëanshme edhe me preventivuesin "Fixed Effects". Si rrjedhim as vlerësuesi "Fixed Effects" e as "Random Effects" nuk mund të jenë të përshtatshme. Andaj modelet e tjera më të avancuara, si "IV-Instrumental Variabel" ose "GMM-Generalized Method Of Moments" mund të jenë alternative që duhet të aplikohen. Përderisa disa nga variablat shpjeguese (të pavarura) të përdorura në modelin e paraqitur në këtë hulumtim shkencor që kam bërë për temën e masterit, supozohen të jenë endogjene, modelet "Fixed Effects" dhe "Random Effects" janë përdorur vetëm për qëllime krahasimore, që përmes tyre të fitohen rezultate efektive dhe të përshtatshme për të operuar me to. Regresioni përfundimtar është realizuar dhe përpunuar duke përdorur një model shumë të avancuar dhe bashkëkohor, i cili është modeli "HausmanTaylor-IV", i cili do të trajtohet në vazhdim të këtij kapitulli, dhe do të mundohem që në mënyrë sa më efikase dhe efektive të përdor këto model dhe të ofrojë rezultate të cilat do të jenë të përshtatshme të përdorën në aspektin e rritjes ekonomike pranë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Stock and Eaton, 2007).

#### 1.4 Modeli Hausman Taylor <sup>15</sup>

Me herët trajtuam disa nga modelet fikse dhe ato të rastit në organizimin e hulumtimeve me modele ekonometrike, ku trajtuam disa argumente dhe fakte të disa studiuesve dhe autorëve të cilët kanë bërë hulumtime në këtë fushë mjaft inovative. (Hausman dhe Taylor, 1981), sugjerojnë një zgjidhje duke kombinuar aspektet e dobishme të të dy vlerësuesve, pra "Fixed Effects" dhe "Random effects", të cilët i trajtuam me herët. Metoda e quajtur "Hausman-Taylor" është një teknikë e njohur si "Instrumental-Variable"<sup>10</sup>, që përdor vetëm informacionet që gjenden tashmë në model, për të eliminuar efektet lidhje reciproke ndërmjet vendeve si dhe "Error Term-In", ndryshe nga preventivuesi. "Fixed Effects", kjo qasje nuk kërkon eliminimin e variablave shpjegues që variojnë përgjatë kohës "Time-Variant" (Cancado, 2005). Testi bën të mundur vlerësimin e signifkancës së një preventivuesi kundrejt një preventivuesi tjetër.

Në veçanti, (Hausman dhe Taylor, 1981), konsiderojnë një model të formës:

$$Y_{it} = X_{IT} + b + Z_{iy} + \alpha_i + n_i$$

Në këtë formulim, të gjithë efektet individuale që shënohen si janë vërejtur. Hausman dhe Taylor, sugjerojnë që të bëhet ndarja e 'X' dhe 'Z' në dy grupe të variablave, edhe atë:

$$x = [x_1 x_2] \text{ dhe } z = [z_1 z_2]$$

<sup>15</sup> HAUSMAN, Jerry A. and William E. Taylor, 1981, Panel Data and Unobservable Individual Effect, *Econometrica*, 49(6), 1377-1398.

ku:  $X_1$  është “  $n \times k_1$  ;

$X_2$  është “  $n \times k_2$  “

$Z_1$  është “  $n \times g_1$  “

$Z_2$  është “  $n \times g_2$ ” dhe n-NT

Atëherë , modeli është:

$$y_{it} = X_{1it} + b_1 + X_{2it} + a_i + Z_{1it}Y_1 + Z_{2it}Y_2 + a_i + n_{it}$$

ku,

$$Y = (Y_1, Y_2) \text{ dhe } B = (B_1, B_2) \text{ dhe } y = (y_1, y_2)$$

Tipari dallues i këtij modeli gjendet tek supozimet mbi korrelacionin ndërmjet efekteve specifike-individuale, dhe grupe të regresorëve që 'variojnë' dhe që 'nuk variojnë'. Katër grupe të variablave të observuar janë përcaktuar në këtë model:

**X1it** është **k1** variabla që variojnë përgjatë kohës dhe nuk janë në korrelacion me  $a_i$  ,

**Z1i** është variabla që nuk variojnë përgjatë kohës dhe nuk janë në korrelacion me  $a_i$  ,

**X2it** është variabla që variojnë përgjatë kohës dhe janë në korrelacion me  $a_i$  ,

**Z2i** është variabla që nuk variojnë dhe janë në korrelacion me  $a_i$  .

Strategjia nga Hausman dhe Taylor është të përdorin informatat që tashmë gjinden në model për instrumentin, pra për variablat problematike “ $X_{2it}$ ” dhe “ $Z_{2i}$ ”. Ata pra propozuan qasjen “IV-Instrumental Variable”, ku variablat e mëposhme janë përdorur si instrumente:  $X_{1it}$ ,  $Z_{1i}$ ,  $X_{2it}$ ,  $Z_{2i}$  nga ku kuptohet se variablat ekzogjene, dmth variablat që nuk janë në korrelacion shërbejnë si instrumente të tyre.

$$E[n_{it}|X_{1it}, Z_{1i}] = 0 \text{ ndonëse } E[n_{it}|X_{2it}, Z_{2i}] = 0$$

$$Var[n_{it}|X_{1it}, Z_{1i}, X_{2it}, Z_{2i}] = \sigma_n^2$$

$$Cov[a_i, n_{it}|X_{1it}, Z_{1i}, X_{2it}, Z_{2i}]$$

$$Var[a_i, n_{it}|X_{1it}, Z_{1i}, X_{2it}, Z_{2i}] = \sigma^2 = \sigma_a^2 + \sigma_n^2$$

Modeli i propozuar nga "Hausman dhe Taylor" është gjithmonë konsistent dhe efikas. Për më tepër, një avantazh i fortë i kësaj qasjeje dhe që e dallon nga qasjet tjera është se nuk duhet të përdoren instrumente të jashtme.

$$Corr[a_i, n_{it}, a_{it}, n_{it}|X_{1it}, Z_{1i}, X_{2it}, Z_{2i}] = \sigma = \sigma_n^2 / \sigma^2$$



## 1.5 Dallimi i modeleve Fixed Effects, Random Effects , Hausman-Taylor-IV

Mënyra më efektive e pranuar e zgjedhjes në mes "Fixed Effects" dhe "Random Effects" është duke përdorur Hausman test (1978). Për më tepër "Hausman Test" mund të përdoret gjithashtu për vendimin nëse "Hausman-Taylor IV" është më i përshtatshëm për tu aplikuar. Testi Hausman është një test kryesisht statistikor që në ekonometri bën të mundur testimin e hipotezave të emëruara nga Jerry A. Hausman. Testi Hausman bën të mundur testimin e hipotezës zero të koeficienteve të vlerësuar nga preventivuesi më efikas "Random Effects" janë të njëjta me ato të vlerësuara nga preventivuesi më konsistent, pra "Fixed effects". Në qoftë se "Hausman Test" jep rezultate me P-vlera insignifikante, pra 'Prob>ch2' më e madhe se '.05', atëherë është më e përshtatshme të përdoret modeli "Random Effects", ndërsa nëse i njëjti test jep rezultate signifikante, atëherë duhet përdorur "Fixed Effects". E njëjta logjikë vlen gjatë përdorimit të "Hausman Test" në vendosjen në mes modeli "Fixed Effects" dhe 'Hausman-Taylor'. Ku '+' nënkupton "Moore-Penrose Pseudoinverse", e cila është e shprehur në gjuhën e matematikës dhe në theks të veçantë algjebërës lineare, një pseudoinverse 'A+' e një matrice 'A', është një përgjithësim i/e matricës inverse. Sipas të dhënave të paraqitura me lart mund të konstatojmë se "Hausman Test" teston hipotezën zero, së koeficientet e vlerësuar nga preventivuesi më efikas "HT-IV" janë të njëjta me ato të vlerësuara nga preventivuesi më konsistent "Fixed effects".

Pra, nëse ato janë P-vlera insignifikante, atëherë "Hausman Taylor-IV" është konsistent dhe njëkohësisht efikas, ndërsa preventivuesi "Fixed Effects" është konsistent, mirëpo jo edhe aq efikas. Pra, "Hausman Test" bën të mundur kontrollimin e një modeli më efikas kundrejt një modeli më pak efikas, por njëkohësisht është bindës në atë për tu siguruar se modeli në fjalë është më efikas, cka do të thotë jep rezultate më të qëndrueshme. Statistikisht "Fixed Effects" është gjithmonë një gjë e arsyeshme për të bërë me Panel Data, pasi që gjithmonë jep rezultate të qëndrueshme, mirëpo mund të mos jetë gjithmonë modeli më efikas për tu përdorur në trajtimin e modeleve ekonometrike. "Random Effects" do të jep p-vlera më të mira për arsye se është një preventivues më efikas, pra mund të përdoret nëse është e justifikueshme statistikisht. "Hausman-Taylor" është më konsistent dhe njëkohësisht efikas, duke qenë zgjedhja më e mirë po të krahasojmë me modelet "Fixed Effects dhe Random Effects".

## III.2 Testimi i determinantave

Në këtë kapitull do të paraqes rezultatet e fituara nga përdorimi i modeleve "Fixed Effects", "Random Effects", ndërsa si model bazë të rritjes së propozuar tek vendet të cilat I kam trajtuar në këtë hulumtim shkencor, do të zgjedhim modelin e HausmanTaylor, ku njëkohësisht do të jap argumente dhe fakte të mjaftueshme që kjo metodë është zgjedhja më superiore në krahasim me modelet e tjera. Duke u bazuar në rezultatin statistikor të "Hausman Test", mund të konstatojmë se metoda e efekteve të rastit, konkretisht "Random Effects", nuk është konsistent që mund të kuptojmë se ka korelacion ndërmjet variablave dhe termit error, ku në fund kuptohet që preventivuesi "Fixed Effects" është zgjedhja më e mirë. Po ashtu duke u mbështetur në propozimin se problemet e endogjenitetit janë të pranishëm në të dhënat e përdorura, kam zgjedhur metodën e

Hausman -Tylor si metodë më e mirë që do ti largoj këto probleme, edhe atë duke përdorur edhe një test të dytë të Husman për të bërë krahasimin ndërmjet “Fixed Effects” dhe Hausman Taylor. Nga dy alternativat e propozuara këtu, si dhe duke u mbështetur në rezultatet e të njëjtit test, mund të konstatojmë se metoda “Hausman- Taylor-IV” është zgjedhja më e mirë.

### III.3 Analiza dhe interpretimi i rezultateve

#### Modelet OLS

Pas testimit të të dhënave të cilat i kam grumbulluar për vendet të cilat janë akoma në tranzicion ekonomik, rezultatet që I morra ishin të pritshme, gjithmonë duke ndjekur edhe logjikën ekonomike në analizimin e faktorëve ose variablave të cilat janë marrë në model.

Le të fillojmë me prezentimin dhe komentimin e të dhënave të analizuara dhe të shohim në qoftë se do t’i vërtetojmë hipotezat e prezentuara në fillimin e këtij punimi.

- a. Me rritjen për 1% të investimeve të huaja direkte (FDI), eksporti ddo të rritet mesatarisht per 0.43% në qoftë se variablat tjera ngelin të pandryshuara (ceteris paribus). Nëse shohim vlerat e *t-testit* (t values) shohim se variabla e marrë në këtë model ka significancë të lartë dhe mund të konkludoj se ky faktor ka ndikim në rritjen e eksportin e Republikës së Maqedonisë dhe vendeve në tranzicion.
- b. Me ndryshimet e kursit të këmbimit për 1%, do të ndikon në zvoglimin e eksportit mesatarisht per 0.01% në qoftë se variablat tjera ngelin të pandryshuara. Vlerat e *t-testit* tregojnë se ky faktor ka significancë dhe ndikon në eksport.
- c. Me rritjen e investimeve të brendshme për 1%, eksporti ne Maqedoni dhe në vendet në tranzicion do të rritet mesatarisht për 0.34% në qoftë se variablat tjera ngelin të pandryshuara. Edhe në këtë rast, vlera e *t-testit* tregon një significancë të lartë të kësaj variable në model dhe mund të konstatojm se ky faktor ndikon në eksport.

Më poshte do të paraqesim një prezentim të shkurtë në mënyrë tabulare të rezultateve të arritura nga modeli i regresionit të thjeshtë linear (OLS).

Variables	OLS	t-test values	Standard Error
FDI	0.4381378	3.31	0.1325266
lnexchngrate	-0.0100713	-1.17	0.0086103
inv	0.3486866	2.27	0.1535731
cons	44.2743	11.68	3.790879
Observations	330	N/A	N/A
F - Test	9.43	N/A	N/A
R- Squared	0.0799	N/A	N/A

Tabela 2: Rezultatet e modelit OLS

Le t'ia hudhim një sy edhe rezultateve të nxjerrura nga analiza e të dhënave të këtyre vendeve duke u bazuar në modelet: fixed effects, random effects dhe Hausman Taylor Model.

### Modelet Random Effects, Fixed Effects, Hausman Taylor

Në kapitullin e mësipërm, ne shpjegojmë në mënyrë të detajuar bazat e analizave që bënë secili model, andaj këtu do të shtjellojmë drejtpërdrejt rezultatet e fituara. Prezentimin e tyre do t'a bëjmë në mënyrë tabelare.

Rezultatet e modeleve			
Variables	Fixed Effects	Random Effects	Hausman Taylor IV
Intradeexpimp	N/A	N/A	0.197415*
FDI	0.2947123**	0.2984927**	0.0632944**
Inexchngerate	-4.25592**	-2.591333**	-7.647117**
inv	0.3929666**	0.3932162**	0.4053266**
cons	52.47755**	49.38601**	38.51649**
Observations	330	330	268
F - Test	26.18	N/A	N/A
chi2	N/A	77.31	73.79
t-test and z-test values			
Variables	Fixed Effects	Random Effects	Hausman Taylor IV
Intradeexpimp	N/A	N/A	4.98
FDI	3.92	3.99	0.81
Inexchngerate	-2.62	-2.18	-3.38
inv	4.35	4.37	4.05
cons	12.3	10.37	2.9

**Shënim:** vlerat e t-testit janë të prezentuara për fixed effects modelin, ndersa për modelet tjera janë prezantuan vlerat e z-testit. Shënim shtesë: (\*) 5% niveli i signifkancës statistikore, (\*\*) 10% niveli i signifkancës statistikore

Vlerat e Standard Error për modelet			
Variables	Fixed Effects	Random Effects	Hausman Taylor IV
Intradeexpimp	N/A	N/A	0.0396077
FDI	0.0752473	0.0748477	0.0783516
Inexchngerate	1.623245	1.188809	2.260755
inv	0.0904353	0.0898808	0.1000627
cons	4.059843	4.763645	13.29239

Nga rezultatet e fituara dhe të prezentuara më lartë, shihet qartë lidhja mes variablave të analizuara në model. Investimet e huaja direkte dhe investimet e brendshme kanë ndikim pozitiv në eksportet tregtare. Këtë e vërtetojnë të tre modelet e analizuara edhe ato:

- a. Në bazë të modelit fixed effects, vërehet se me rritjen për 1% të FDI, eksportet do të rriten mesatarisht për 0.29%. E njëjta ndodhe edhe te modeli i random effects (0.29%) dhe te Hausman Taylor (0.19%). Me këtë mund të konstatojmë se vërtetohet hipoteza *H1/1: Investimeve të huaja direkte kane ndikim të konsidreueshëm pozitiv në rritjen e eksportit të Republikës së Maqedonisë*. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për vendet e tranzicionit, ku efektet e investimeve të huaja direkte janë të ngjashme. Për significancën e faktorëve të marrë në model flasin vlerat e t-testit dhe z-testit përkatësisht. Vlerat tregojnë se variablat e marra në model janë signifkante.
- b. Pohime të ngjashme do mund të themi edhe për variablën e investimeve të brendshme ku efektet e saj positive vërehen tek te tre modelet, ku me rritjen për 1% të investimeve të brendshme do të kemi rritje mesatare të eksportit për 0.39% (fixed effects dhe random effects), përkatësisht 0.40% (Hausman Taylor). Signifikancën e kësaj variable në këto modele e tregojnë vlerat e t-testit dhe z-testit, ku edhe për këtë variabël janë të larta dhe signifkante.
- c. Rezultate interesante marrim në qoftë se në model e fusim variablën e kursit të këmbimeve që ka treguar efekt negativ në rritjen e eksporteve. Vlerat negative -4.2% (fixed effects), -2.59% (random effects) dhe -7.6% (Hausman Taylor) janë si rezultat i ndryshimeve të kurseve valutore të cilat janë përdorur gjatë realizimit të eksporteve të ndryshme me vende të ndryshme. Me fjalë të tjera, kjo tregon se me ndryshim të kurseve të këmbimit për 1%, eksportet do të zvogëlohen mesatarisht për përqindjet e përmendura më lartë, në qoftë se variablat tjera ngelin të pandryshuara. Në bazë të këtyre rezultateve, supozoj që për kohën në të cilën e kam marrë në analizë, kursi devizor nuk ka qenë në favor të vendeve të cilat kanë eksportuar mallra (vlera e valutës kombëtare ka qenë e zhvlerësuar), me ç'rast ka ndikuar në uljen e vlerës nominale të mallrave dhe shërbimeve që janë tregtuar.

Nga rezultatet e mësipërme, tashmë mund të bëj vlerësimin tim personal për sa i përket dukurisë së investimeve të huaja direkte dhe ndikimit të tyre në eksportin e Republikës së Maqedonisë dhe vendeve në tranzicion.

### III.4 Konkluzioni dhe rekomandimet

Një prej qëllimeve kryesore të këtij punimi ka qenë identifikimi i faktorëve të rëndësishëm që ndikojnë në zhvillimin e eksportit të shtetit tonë, duke cilësuar gjithmonë që eksporti është një pre armëve më të fuqishme e zhvillimit ekonomik të një vendi. Eksporti është një indikator crucial, që tregon edhe fuqinë prodhuese të një vendi, që do të thotë, në qoftë se eksporti i një vendi është i lartë, atëherë ai vend tashmë i ka plotësuar nevojat e brendshme për mallrat dhe shërbimet që i prodhon dhe se suficitin e tyre ua shet vendeve fqinje dhe mbarrë botës.

Për të pasur këtë nivel të lartë të eksportit, natyrisht që duhet të kemi një infrastrukturë të mirë organizuar ekonomike, ku të gjithë agjentët ekonomike bashkëveprojnë njëri me tjetrin dhe resuset e tyre i përdorin dhe i alokojnë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe me ç'rast arrihet produktiviteti maksimal. Në sektorin e prodhimitarisë, padyshim që investimet e larta kapitale janë shumë të nevojshme, sidomos kur këto investime orientohen në blerjen e maqinerive të mëdha në fushën e bujqësisë, energjisë, xehtarisë dhe industrisë së rëndë.

Republika e Maqedonisë gjatë dekadës së fundit ka qenë e fokusuar më shumë në pregaditjen e infrastrukturës ligjore për tërheqjen e investimeve të huaja direkte dhe krijimin e kushteve më të mira që ndërmarrjet e huaja të operojnë në tregun vendas. Megjithatë, edhe pse kushtet ligjore dhe tregtare janë shumë të volitshme për të investuar në vendin tonë, niveli i investimeve të huaja direkte ka qenë në nivel të ulët nga ai që është pritur. Kjo situatë vjen si rezultat i klimës së pasigurtë politike që mbizotron me dekada në vendin tonë, niveli i lartë i korupsionit, diskriminimit etnik, niveli i ulët i të ardhurave të popullatës etj. Faktorët që i përmenda më lartë janë edhe ato arsye pse më shtynë mua që t'a realizoj këtë punim. Andaj vendosa që në bazë të të dhënave zyrtare të shoh efektin që kanë sjellur investimet e deritanishme të huaja ne eksportin e vendit tonë dhe vendeve në tranzicion.

Si një vlerësim të përgjithshëm të rezultateve të arritura me anë të kësaj analize dhe modeleve, mund të konstatoj që modelet kanë një signifikançë dhe faktorët e marrë në analizë, ndikojnë në rritjen apo zvogëlimin e eksportit të vendeve të analizuara. Me ç'rast, mund të konstatojmë se vërtetohet *hipoteza alternative H1/1: Investimet e huaja direkte kanë ndikim të konsiderueshëm pozitiv në rritjen e eksportit të Republikës së Maqedonisë*. Me fjalë të tjera, këto variabla janë të lidhura njera me tjetrën dhe kanë një interaksion të ngushtë ndërmjet veti. Duke u nisur nga kjo, qeveritë e vendeve do duhet të inkurajohen që përveç investimeve të brendshme, ato duhet që sa më shumë të thithin investime të huaja direkte edhe nga vendet tjera, pasi që këto ndikojnë pozitivisht në rritjen e Bruto Prodhimit Vendor dhe me këtë, stimulojnë eksportin e produkteve, nxitjen e marrëdhënieve tregtare midis vendeve të ndryshme si dhe përmirësimin e bilancit tregtar.

Në epilogun e këtij punimi, dua të theksoj që gjetjet e mia gjatë analizës së të dhënave dhe faktorëve ekonomik, me theks të veçantë në analizën e investimeve të huaja direkte dhe ndikimin e tyre në eksport, janë të ngjashme edhe me rezultatet e studiusve tjerë që kanë analizuar këtë aspekt ku prej tyre po përmend vetëm disa, edhe atë: Heinz Hollenstein dhe Martin Berger (2015), Nuzhat Falki (2009), Dr. Sauéaluck Koojaroenprasis etj.

Me anë të këtij punimi dua që të inkurajoj qeveritë e ardhshme që të fokusohen më shumë në tërheqjen e investimeve të huaja direkte në vendin tonë, pasi që studimet empirike tregojnë se ato kanë efekt pozitiv në rritjen ekonomike dhe rritjen e eksporteve. Kjo do të sjell një zinxhir pozitiv të efekteve ekonomike edhe atë: ndikim pozitiv në mirëqëenien ekonomike të vendit, stimulim të ndërmarrjeve ekonomike për rritjen e prodhimtarisë, stimulimin e konkurrencës, shfrytëzim të resurseve humane dhe kapitale, përmirësimin e bilancit tregtar (zvogëlimin e deficitit të lartë që momentalisht Maqedonia e ka), forcimin e valutës vendase etj.

Dhe në fund, si limitim të këtij punimi mund të cek mungesën e variablave të tjerë ekonomikë që nuk janë marrë parasysh në modelin tonë por që ndikojnë në rritjen apo zvogëlimin e eksporteve (kjo vlen për të gjithë vendet e tranzicionit) dhe aspekti kohor i të dhënave që është marrë në model. Le të shpresojmë që në punimet e rradhës do të krijojmë modele më gjithëpërfshirëse dhe do t'i analizojmë dukuritë ekonomike në nivel më të lartë dhe më të detajizuar.

### III.5 Referencat e shfrytëzuara

1. Oltjana Zoto – Investimet e huaja direkte ne Shqipëri, analizë e efekteve, politikave dhe lidhja me rritjen ekonomike
2. Jeff Madura-Drejtimi Financiar Ndërkombëtar, Investimet e Huaja Direkte.
3. International Business: A Strategic Management Approach, Alan M. Rugman, Richard M. Hodgetts, 1995
4. Internationalisation Strategies , G. Chrysochoidis, Millar Clegg, 1997
5. Foreign Investment, transnationals and developing countries, Sanjaya Lall and Paul Streeten, 1977
6. The impact of FDI o Growth in Developing Countries: An African Experience, Adewumi S, 2006
7. Multinational firms, Location and Trade, James R. Markusen, 1998
8. Oil and the Stock Markets, Charles M. Jones, Gautam Kaul, 1996
9. Cross-sectional Dependence in Panel Data Analysis, Vasilis Sarafidis and Tom Wansbeek,2010
10. Basics of econometrics, Fourth Edition, Damodar N. Gujarati
11. Analiza e kursit devizor në Republikën e Maqedonisë, Besnik Fetaj, Tetovë 2014, fq 8
12. Introduction to Regression and Analysis of Variance, Fixed vs. Random Effects, Jonathan Taylor
13. HAUSMAN, Jerry A. and William E. Taylor, 1981, Panel Data and Unobservable Individual Effect, *Econometrica*, 49(6), 1377-1398.
14. Domestic Investment as a drive of Economic Growth in Libya, Naseer Tawiri, 2010
15. The Impact of public investment on Economic Growth in Pakistan, Ejaz Ghani and Musleh-Ud Din, 2006
16. Role of Invesmten in the Course of Economic Growth in Pakistan, Maqbool Hussain Sial, Maida Hussain Hashmi, Sofia Anwar, 2010
17. Effect of Public and Private Investment on Economic Growth in Bangladesh: an econometric analysis, Sheikh Touhidul Haque, 2013
18. The impact of Investment in IT on Economic Performance: Implications for Developing Countries, Rouben Indjikian and Donald S. Siegel, 2005
19. The impact of Public and Private Investment on Economic Growth: evidence from Developing Asian Countries, Kongphet Phetsavong and Masaru Ichihashi, 2012
20. The Effects on Public Sector Investments on Economic Growth of Croatia, Sasha Drezgic, 2008
21. Exploring Impact of Macro Economic Variables on GDP of Pakistan, Sidrat Jilani, Farooq – E – Azam Cheema, Muhammad Asim, 2010
22. Global Savings, Investment and World Real Interest Rates, Brigitte Desroches and Michale Francis, 2007
23. Clashes and Compromises:Investment Policies in Tourism Destinations, Guido Candela, Massimiliano Castellani, Maurizio Mussoni, 2012
24. External Factors Affecting Investment Decisions of Companies, Piotr Bialowolski and Dorota Weziak-Bialowolska, 2014
25. Does Growth Attract FDI?, Sasi Iamsiraroj and Hristos Doucouliagos, 2015
26. Choice of Foreign R&D Entry Mode and Its Relation to Firm Performance: A Firm-level Analysis for Switzerland and Austria, Heinz Hollenstein and Martin Berger, 2015

27. What Determines Whether Preferential Liberalization of Barriers against Foreign Investors in Services Are Beneficial or Immizerising: Application to the Case of Kenya, Edward J. Balistreri, Jesper Jensen, and David Tarr, 2015
28. Do Transfer Costs Matter for Foreign Remittances? A Gravity Model Approach, Junaid Ahmed and Inmaculada Martínez-Zarzoso, 2016

Literaturat e shfrytëzuara nga interneti:

1. <https://www.oecd.org/daf/inv/investmentstatisticsandanalysis/40193734.pdf>
2. [http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat\\_NadvoresnaTrgovija\\_Indikator/125\\_pokrienost\\_ml.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef](http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/mk/MakStat/MakStat_NadvoresnaTrgovija_Indikator/125_pokrienost_ml.px/table/tableViewLayout2/?rxid=46ee0f64-2992-4b45-a2d9-cb4e5f7ec5ef)
3. <https://www.oecd.org/>
4. <https://www.imf.org/external/index.htm>
5. <https://www.worldbank.org/>
6. <https://investnorthmacedonia.gov.mk/>



## IV. Rezultatet e punimit

### OLS Metoda

```
. regress tradeexportimport fdi exchangerate inv
```

Source	SS	df	MS	Number of obs	=	330
Model	7632.7848	3	2544.2616	F(3, 326)	=	9.43
Residual	87953.2887	326	269.795364	Prob > F	=	0.0000
				R-squared	=	0.0799
				Adj R-squared	=	0.0714
Total	95586.0735	329	290.535178	Root MSE	=	16.425

tradeexpor~t	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
fdi	.4381378	.1325266	3.31	0.001	.1774225 .6988531
exchangerate	-.0100713	.0086103	-1.17	0.243	-.0270101 .0068674
inv	.3486866	.1535731	2.27	0.024	.0465673 .6508059
_cons	44.26743	3.790879	11.68	0.000	36.80976 51.7251

### Fixed Model Metoda

```
. xtreg tradeexportimport fdi lnexchangerate inv, fe
```

```
Fixed-effects (within) regression          Number of obs   =       330
Group variable: code                      Number of groups =        22

R-sq:                                     Obs per group:
    within = 0.2048                       min =           9
    between = 0.0216                      avg =          15.0
    overall = 0.0442                      max =           16

corr(u_i, Xb) = -0.3733                   F(3,305)        =       26.18
                                           Prob > F        =       0.0000
```

tradeexporti~t	Coef.	Std. Err.	t	P> t	[95% Conf. Interval]
fdi	.2947123	.0752473	3.92	0.000	.1466427 .4427819
lnexchangerate	-4.255692	1.623245	-2.62	0.009	-7.449869 -1.061515
inv	.3929666	.0904353	4.35	0.000	.2150104 .5709227
_cons	52.47755	4.059843	12.93	0.000	44.4887 60.46639
sigma_u	16.714083				
sigma_e	7.3389213				
rho	.83836592	(fraction of variance due to u_i)			

```
F test that all u_i=0: F(21, 305) = 62.86          Prob > F = 0.0000
```

## Random Effects Metoda

```
. xtreg tradeexportimport fdi lnexchangerate inv, re
```

```
Random-effects GLS regression           Number of obs   =       330
Group variable: code                   Number of groups =        22

R-sq:                                   Obs per group:
    within = 0.2021                     min =           9
    between = 0.0288                     avg =          15.0
    overall = 0.0606                     max =           16

corr(u_i, X) = 0 (assumed)              Wald chi2(3)    =       77.31
                                           Prob > chi2     =       0.0000
```

tradeexporti~t	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
fdi	.2984927	.0748477	3.99	0.000	.1517939	.4451915
lnexchangerate	-2.591333	1.188809	-2.18	0.029	-4.921356	-.261311
inv	.3932162	.0898808	4.37	0.000	.2170531	.5693793
_cons	49.38601	4.763645	10.37	0.000	40.04944	58.72258
sigma_u	16.070093					
sigma_e	7.3389213					
rho	.82743209	(fraction of variance due to u_i)				

### Hausman Taylor IV Metoda

```
. xthtaylor tradeexportimport tradeexpimport_lag1 fdi inv lnexchangerate cod, endog( fdi lnexchangerate )
```

```
Hausman-Taylor estimation      Number of obs   =       268
Group variable: code          Number of groups =        20

                                Obs per group:
                                min =         2
                                avg =       13.4
                                max =        16

Random effects u_i ~ i.i.d.    Wald chi2(5)    =       73.79
                                Prob > chi2       =       0.0000
```

tradeexpor~t	Coef.	Std. Err.	z	P> z	[95% Conf. Interval]	
TVexogenous						
tradeexpim~1	.1974152	.0396077	4.98	0.000	.1197854	.2750449
inv	.4053266	.1000627	4.05	0.000	.2092074	.6014458
TVendogenous						
fdi	.0632944	.0783516	0.81	0.419	-.0902721	.2168608
lnexchange~e	-7.647117	2.260755	-3.38	0.001	-12.07812	-3.216119
TIexogenous						
code	.7177151	.9087611	0.79	0.430	-1.063424	2.498854
_cons	38.51649	13.29239	2.90	0.004	12.46389	64.56909
-----						
sigma_u	23.780592					
sigma_e	6.5504256					